RILINDJA

MUZEU I ARTIT BASHKËKOHOR TË KOSOVËS

RILINDJA

MABK RILINDJA

PËRMBAJTJA

6—7 Akronimet
8—19 Përmbledhje ekzekutive
Historiku i artit bashkëkohor në Kosovë
Nevoja për MABK
Këshilli Inicues i MABK
Legjislacioni në Kosovë
20—31 Kontekstet e arkitekturës
32—37 Programi dhe funksionet
38—47 Statuti i Muzeut të Artit Bashkëkohor të Kosovës — Rilindja
48—59 Departamentet dhe organogrami
60—65 Koleksioni
66—67 Fazat e punës
69—70 Impressum

AKRONIMET

Emri i plotë i institucionit do të jetë:
Muzeu i Artit Bashkëkohor të Kosovës — Rilindja

Emri i shkurtuar i institucionit do të jetë:
MABK Rilindja

Akronimi i institucionit do të jetë:
MABK

Në vijim të këtij teksti do të përdoren edhe këto akronime për institucione të tjera:

AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
BE	Bashkimi Evropian
COVID-19	Coronavirus Disease 2019
GKK	Galeria Kombëtare e Kosovës
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
MABK	Muzeu i Artit Bashkëkohor të Kosovës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
PMA	Principet e Muzeve te Artit

1. Përmbledhje ekzekutive

Muzeu i Artit Bashkëkohor është një institucion me rëndësi për kulturën e Kosovës, në veçanti për artin pamor. Prej iniciativave të para, në vitet e shtatëdhjeta, e deri te planet për ndërtimin e godinës së re për një institucion të tillë pas në dy dekadat e fundit ka pasur në vazhdimësi sfida që kanë pamundësuar krijimin e një institucioni të tillë. Është koha e duhur që ky projekt të merr konturat e duhura dhe të nisë punën shumë të pritur nga publiku dhe komuniteti kulturor. Në vazhdim do të paraqesim një plan pune për themelim të shpejtë të këtij institucioni, duke u mbështetur në punë paralele në dy fusha të ndryshme: 1. themelimin e institucionit (koleksioni dhe burimet njerëzore), dhe 2. projektet për ndërtesën (arkitektura, ndërtesa, ekspozita).

Këshilli Inicues për Muzeun e Artit Bashkëkohor është themeluar me vendim të ministrit Hajrulla Çeku nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë më 31 maj 2022 (Nr. 75/2022). Është i përbërë nga: Yll Rugova (kryesues), Petrit Halilaj, Flaka Haliti, Sislej Xhafa, Erëmirë Krasniqi, Zake Prelvukaj, Nita Salihu Hoxha, Valdete Pacolli, Fisnik Abazi, përfaqësues i MKRS-së. Anëtar pa të drejtë vote është: Rozafa Imami (MKRS), dhe sekretare: Arbenita Nuza (MKRS).

2. Historiku i artit bashkëkohor në Kosovë

Profesionalizimi në diciplinat e arteve pamore në Kosovë ka filluar nga viti 1949 me hapjen e Shkollës së Mesme të Arteve në Pejë. Gjeneratat e para të artistëve pamorë kanë marrur edukimin bazë në këtë institucion, gjë që i ka përgaditur për të vijuar studimet universitare në qendrat kulturore jugosllave. Ndër mësimdhënësit, mentorët dhe artistët e parë konsiderohen Shemsedin Kasapolli, Vlada Radović, Nusret Salihamixhiqi, Gjelosh Gjokaj dhe Muslim Mulliqi. Arti modern socialist mund të konsiderohet si qasja dominante në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore. Nisur nga nevojat ekspozuese që arti modern socialist kishte, u krijuan institucionet e artit në Kosovë dhe resurset njerëzore në këtë sektor.

Institucione të tjera të rëndësishme të kësaj periudhe janë Shkolla e Lartë Pedagogjike - Drejtimi Art Figurativ e themeluar në vitin 1958 dhe Akademia e Arteve të Bukura e themeluar në vitin 1973 në Prishtinë. Nga këto dy institucione kanë diplomuar shumë artistë të rëndësishëm të vendit, dhe këto struktura arsimore janë ende aktive edhe sot në fushën e pikturës, skulpturës, artit grafik dhe aplikativ.

Jugosllavia kishte një sistem multi-centrik të artit, por kjo nuk nënkuptonte që të gjitha qendrat e saj ishin njëjtë të zhvilluara. Në mungesë të hapësirave ekspozuese në Kosovë, nga vitet ‘50 deri në fundin e viteve ‘70, foajea e Teatrit Kombëtar ishte përdorur si hapësirë ekspozuese. Pa një strukturë formale, arti i Kosovës kishte mbetur i panjohur për publikun ndërkombëtar. Me autonominë e vitin 1974, Kosovës iu mundësua të realizojë shumë nga projektet kapitale në kulturë dhe të përfitojë nga subvencionet e destinuara për regjionet më pak të zhvilluara të federatës.

Një ndër ato projekte kapitale ishte Pallati i Rinisë dhe Sporteve Boro Ramizi, ku fillimisht ishte e vendosur Galeria e Arteve të Prishtinës, që sot njihet si Galeria Kombëtare e Kosovës (GKK). E themeluar në vitin 1979, GKK është institucioni i vetëm i lartë publik që merret me prezantimin dhe promovimin e arteve pamore. Ekspozita e parë ishte “Bashkëkohësit tanë”, që prezantoi vepra nga tre disciplina: pikturë, skulpturë, grafikë. Ishin 33 artistë vendorë pjesëmarrës, të cilët u prezantuan me gjithsej 57 vepra. Ndër ta ishin Alije Vokshi, Fevzi Tüfekçi, Agim Çavderbasha, Svetomir Arsić - Basara, Budim Berisha, Hilmija Ćatović, Svetozar Kamenović, Muslim Mulliqi, Xhevdet Xhafa, Kadrush Rama, Rexhep Ferri dhe të tjerë.

Fillimisht këto vepra të prezantuara ishin mbledhur dhe ruajtur në kuadër të Qendrës Kulturore Propagandistike. Në mungesë të institucioneve adekuate të artit dhe kulturës, kjo qendër ishte hapësirë shumëfunksionale shtetërore. Me themelimin e Galerisë, koleksioni i Qendrës Propagandistike Kulturore iu dhurua institucionit-në-bërje, GKK-së. Sot, GKK ka në dispozicion një koleksion me mbi një mijë vepra nga artistë të periudhave të ndryshme nga Kosova, regjioni dhe bota. Ky koleksion për momentin është i kategorizuar dhe ndodhet në depon e këtij institucioni, larg nga sytë e publikut.

Deri në vitin 1989, arti modern i Kosovës u prezantuan në shumë qendra të hapësirës jugosllave dhe qendra tjera prestigjioze të njohura botërore. Artistët kosovarë u afirmuan dhe u vlerësuan shumë për shkak të sistemit të artit mirë të organizuar, shoqatave të artit figurativ dhe aplikativ,

dhe po ashtu për shkak të qasjes së tyre origjinale moderne. Pas vitit 1990, për shkak të luftërave në Jugosllavi, sistemi socialist i artit u shkatërrua, dhe bashkë me të shoqatat e artistëve dhe rrjetet përmes të cilave artistët e Kosovës prezantoheshin në regjion dhe më gjerë.

Revokimi i autonomisë së Kosovës në vitin 1989, sjellë një kontekst të ri politik për artin dhe një zhvillim kryesisht jashtë institucioneve të kulturës të ndërtuara gjatë periudhës së socializmit. Një mënyrë për të i naviguar vështirësitë nën okupim ishte krijimi i hapësirave të reja publike përbrenda sferave tradicionale private si p.sh. shtëpi, garazha, oborre private. Në këtë sferë u bartë i tërë sistemi arsimor i nivelit universitar. Ky sistem i mbështetur nga një bazë e gjerë qytetare, po ashtu ka qenë e mbështetur nga profesorët e artit të cilët i ofruan studiot e tyre private të përdoreshin si klasa. Kështu duke mundësuar edukimin në diciplina të ndryshme të artit. Ndërsa, si hapësira alternative të ekspozimit shfrytëzoheshin baret dhe kafeteritë.

Me shpërbërjen e Jugosllavisë në vitin 1990, u shfaq edhe nevoja për t'u shkëputur nga trashëgimia socialiste në art, por edhe për të adaptuar pozicione të reja diskursive dhe për të integruar media të reja audio-vizuale. Artistë më të shquar të kësaj periudhe janë: Sokol Beqiri, Mehmet Behluli, Erzen Shkololli, Rudina Xhaferi dhe Albert Heta. Këta kryesisht ekspozoheshin në Galerinë Dodona, që mbështetej nga Fondacioni Soros dhe udhëheqej nga Alisa Maliqi, si dhe në Hanin e Dy Robertëve, që ishte kafiteri dhe hapësirë ekspozuese dhe udhëheqej nga Merita dhe Fadil Dragaj.

Gjatë Luftës së Kosovës 1999, shumë studio u dogjën dhe shumë vepra arti u shkatërruan ose humbën. Megjithatë, koleksioni i GKK-së u ruajt pothuajse në tërësi, dhe ky koleksion përbën një pikënisje të rëndësishme për të studjuar dhe hulumtuar artin e zhvilluar në Kosovë në shekullin XX. Ndërsa, në dekadën e parë pas luftës 1999, Galeria e Kombëtare e Kosovës organizoi më shumë se 350 ekspozita kolektive dhe individuale nga artistë vendorë dhe ndërkombëtarë. Mijëra artistë kanë ekspozuar veprat e tyre, të cilat u vizituan nga qindra mijëra artdashës.

Menjëherë pas luftës, në vitin 1999, themelohet Instituti për Art Bashkëkohor - Exit në Prishtinë, i drejtuar nga Sokol Beqiri dhe Erzen Shkololli. Programi kryesor i tyre Missing Identity i vitit 2003 ngërthente në vete programe të formateve të ndryshme edukative për studentë të shkencave shoqërore dhe artistë. Këto programe ishin të strukturuara si punëtori, ligjerata, ekspozita dhe vizita studimore si pjesë të bashkëpunimeve ndërkombëtare.

Njëkohësisht, Instituti kishin hapur edhe hapësirën ekspozuese Exit në Pejë, ku u ekspozuan artistë si: Maja Bajević, Anri Sala, Stefano Romano, Gentian Shkurti, dhe të tjerë. Si dhe u prezantuan projekte kuratoriale të kolektivit WHW, Inke Arns, Edi Muka dhe të tjerë. Po ashtu, bashkëpunimi më i rëndësishëm ishte me Universitetin Shtetëror të Arteve të Bukura - Städelschule, Frankfurt am Main në kuadër të Academy Remix në vitin 2004. Exit po ashtu publikonte fletushkën e përjavshme Arta si pjesë e gazetës Java.

Edhe pse ndërtesat zyrtare të institucioneve kulturore ishin rikthyer në dispozicion të artistëve pas vitit 2000, punët më me ndikim kanë vazhduar të prodhohen në hapësira të improvizuara. Kafeteritë dhe ambientet joformale si Internet Disko, Tetris dhe Tingle Tangle mund të veçohen nga kjo periudhë (2005-2012). Këto hapësira funksiononin si hapësira të udhëhequra nga kolektive të artistëve. Ishin të vetë-financuara dhe në to lëshohej muzikë indie, organizoheshin shfaqje të filmave arthouse, lexime letrare, si dhe enterieret e tyre shquheshin me murale të punuara nga artistë që ishin pjesë të kolektivit.

Në vitin 2006, peisazhit kulturor i shtohet edhe Stacion Qendra për Art Bashkëkohor në Prishtinë, e udhëhequr nga Albert Heta dhe Vala Osmani. Programi i kësaj qendre fillimisht ishte i fokusuar në ekspozita individuale, shkëmbime, rezidenca artistike. Mirëpo, që nga viti 2015, me përvetësimin e hapësirës së Klubit të Boksit, kjo qendër organizon edhe shkollën verore - Shkolla Verore si Shkollë, e cila përvjetshëm mbledh një numër të madh të teoricientëve dhe praktikuesve të diciplinave të ndryshme.

Pas aplikimit të suksesshëm për organizimin e bienales nomade të artit Manifesta në vitin 2018, kjo ngjarje e madhe e artit bashkëkohor është mbajtur në kryeqytetin e Kosovës në vitin 2022. Mbi njëqind artistë kanë shfaqur veprat e tyre në 25 lokacione të ndryshme gjithandej qytetit, duke e kthyer Prishtinën për disa muaj në një qendër të rëndësishme të artit në Evropë. Kjo ngjarje i dha edhe një shtytje artit lokal, pasi që një pjesë e madhe (mbi 30%) e artistëve të prezantuar në Manifesta 14 ishin nga Kosova. Kështu duke rritur dukshmërinë e artistëve lokal të gjeneratave të ndryshme.

Sot, ndër artistët më të njohur të Kosovës janë Petrit Halilaj, Flaka Haliti dhe Sislej Xhafa, përderisa edhe artistë tjerë si Jakup Ferri, Alban Muja, Driton Selmani, Leunora Salihu, dhe Doruntina Kastrati kanë prani të madhe ndërkombëtare. Nga viti 2013, Kosova përfaqësohet edhe në Bienalen e Artit Bashkëkohor në Venedik, përderisa disa prej artistëve janë pjesë e koleksioneve të përhershme në Pompidou të Parisit, Kontakt Collection të Vjenës, Maxxi Museum të Romës, dhe të tjera.

3. Nevoja për Muzeun e Artit Bashkëkohor

Muzeu i Artit Bashkëkohor është i rëndësisë së veçant për Kosovën pasi që do të krijonte një strukturë të re institucionale e cila do të u përgjigjej nevojave të sotme të artit. Krahas Galerisë Kombëtare të Kosovës, do të ndërtonte kuadro të reja profesionale me fokus në hulumtim, interpretim të trashëgimisë pamore, dhe mbledhje dhe ruajtje të veprave të artistëve bashkëkohorë vendorë dhe ndërkombëtare. Tutje, do të krijonte një hapësirë më inovative dhe akomoduese për praktika të reja institucionale, të cilat do të mund të barteshin nëpër institucionet e tjera publike të vendit që kanë profil të njëjtë apo të ngjashëm.

Muzeu do të kuronte programe vjetore: programin e ekspozitave, programi i publikimit dhe hulumtimit dhe programe edukative që nisen nga temat vjetore hulumtuese të muzeut. Këto programe publike do të dizajnoheshin për publikun e moshave të ndryshme, por edhe me prapavi diverse kombëtare duke pasur parasysh kombësitë e shumta që jetojnë në Kosovë. Ky muze do të nxiste veprimtarinë artistike përmes vizitave të organizuara nga publiku i gjerë dhe institucionet arsimore. Duke prezantuar veprat e rëndësishme të autorëve të ndryshëm, muzeu të shërbente si hapësirë studimi për hulumtues, historianë dhe teoriticientë të artit.

Gjithsesi vëmendje të shtuar do t'i ipet studentëve dhe nxënësve fillor, që muzeu të ofrojë një ambient që nxit kurreshtje dhe edukim estetik. Me një infrastrukturë të tillë për ekspozim, institucionet arsimore do të kenë mundësi të organizohen për vizita të përbashkëta edukative. Mundësia e njejtë do të ipej edhe vizitorëve të qyteteve të ndryshme të Kosovës, megjithëse kjo hapësirë do të përmbushë edhe nevojat kulturore të turistëve që e vizitojnë vendin, duke e krijuar një mundësi shtesë për t'u njohur me kulturën e gjerë dhe artin pamor të vendit. Muzeu do të kuronte edhe programin e vetë edukativ, duke targetuar grupe të ndryshme dhe duke u kthyer këtë hapësirë në një forum të shkëmbimit të ideve dhe të zhvillimit të edukimit estetik.

Sipas planifikimit tonë, kjo hapësirë do të mund të ishte pjesërisht e vetëqëndrueshme duke e bërë hyrjen me bileta, duke shitur publikimet e botuara nga MAB, por po ashtu edhe suvenire dhe reprodukcione nga koleksioni i saj. Si pjesë e kompleksit të ndërtesës do të mund të ishte edhe një kafeteri, nji galeri për studim, bibliotekë me literaturë të specializuar, ngjashëm si në muzeumet dhe hapësirat e ngjashme në botë. Si pjesë e misionit të saj, muzeu do konceptohej si pikëtakim i komuniteteve të ndryshme profesionale, por po ashtu do të angazhohej në demokratizimin e historisë lokale të artit, krijimin e qasjes në informacion dhe koleksion, krijimin e qasjes në arkivën e brendshme, si dhe krijimin e një ambienti më gjithëpërfshirës që adreson çështje të komuniteteve më pak të privilegjuara dhe atyre thellësisht të margjinalizuara.

Kosova është i vetmi vend në Evropë dhe rajon pa një muze të tillë. Galeria e Kombëtare e Shqipërisë e ka hapësirën e dedikuar për koleksionin e saj të përhershëm, ndërkohë që në Shkup në vitet '60, pas termetit është ndërtuar një muze i ri ku nga e gjithë bota janë dhënë donacione të pikturave. Sot, Muzeu i Arteve Bashkëkohore në Shkup ka një koleksion të pasur të veprave që mund të vizitohen në orare të caktuara. Me hapjen e këtij muzeu si qendër të arteve do të krijohej mundësia edhe për blerje të reja të veprave artistike nga autorët lokal dhe ndërkombëtar, duke e pasuruar këtë koleksion edhe më tutje.

Muzeu gjithashtu do të bëhej qendër gravituese për studjuesit e rinjë, të cilët në mungesë të institucioneve të këtij profili gjerë më tani nuk kanë bërë punë hulumtuese të fokusuar në artin bashkëkohor. Muzeu do të mudësonte hulumtim dhe dokumentim sistematik. Një institucion i tillë do të mundësonte edhe historizimin e artit në tridhjetë vitet e fundit. Një përpjekje si kjo i shton vlerë dhe krijon perspektiva të reja të leximit dhe interpretimit të trashëgimisë pamore të vendit. Një histori e artit lokal, sado tentative, do të adresonte mungesën e vazhdimësive diskursive në mes të lëvizjeve të ndryshme artistike në vend. Mirëpo, për të prodhuar dije dhe njohuri lokale, e domosdoshme është infrastruktura institucionale që të ofrojë siguri në punë dhe kontrata afat-gjate për punonjësit në kulturë që edhe hulumtimet të jenë më të thelluara në art.

Së këndejmi, arti konsiderohet vlerë e rëndësishme kulturore e një vendi, dhe është koha e duhur që edhe ne të mendojmë për qëllime afat-gjata, përfshi këtu edhe pasurimin e koleksionit tonë. Megjithëse, ne kemi vepra të artit si pjesë të koleksionit të GKK-së nga Henry Moore, James Rosenquist, Cy Twombly, Vasarely dhe Andy Warhol, pasurimi me vepra të reja do të ishte hap tutje në përditësimin e koleksionit, por edhe krijimit të qasjes në artin e botës përmes institucioneve vendore. Kjo njëkohësisht do të plotësonte kërkesat kulturore të qytetarëve dhe komunitetit artistik. Për më tepër, kjo do të kishte ndikim në imazhin e vetë Kosovës, si krijuese e institucioneve të pajisura me ekspertizën e duhur për të mbledhur dhe ruajtur trashëgimi botërore.

Muzeu do të ndikonte edhe në jetën e qytetarëve të lagjes ku do të vendosej, duke i urbanizuar ato lagje tutje, dhe sjellur infrastrukturë miqësore për qasje në kulturë dhe art. Kërkesa për jetë më të pasur kulturore për të gjithë banorët ende nuk është se plotësohet nga institucionet e vendit, dhe ky muze do të adresonte këtë boshllëk.

4. Këshilli Inicues i Muzeut të Artit Bashkëkohor

Me programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, arti dhe kultura llogariten si kontribuues qenësor në mirëqenien shoqërore e ekonomike. Në këtë program, parashihet konceptimi dhe themelimi i institucioneve të reja kombëtare të kulturës, në mesin e tyre edhe Muzeun e Artit Bashkëkohor.

Me qëllim të hapjes së procesit të ndërtimit të institucionit të MAB me anë të prurjes së kuadrove vendore në formacion ku do të përdorej përvoja ndërkombëtare dhe do të vinin në funksion aftësitë dhe njohuritë e përfituara nga puna e dëshmuar shumëvjeçare në industrinë e artit dhe të kulturës nga anëtarët e këshillit , Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka nxjerrë vendimin për angazhimin e Këshillit Inciues të Muzeut të Artit Bashkëkohor. Anëtarë të KIMAB janë: Yll Rugova (kryesues), Petrit Halilaj, Flaka Haliti, Sislej Xhafa, Erëmirë Krasniqi, Zake Prelvukaj, Nita Salihu Hoxha, Valdete Pacolli, Fisnik Abazi, përfaqësues i MKRS-së. Anëtare pa të drejtë vote është: Rozafa Imami (MKRS), dhe sekretare: Arbenita Nuza (MKRS).

Mandati i KIMAB me detyrat dhe përgjegjësitë sipas vendimit 75/2022 të datës 31 maj 2022 nga ministri Hajrulla Çeku i MKRS-së, janë si në vijim:

- Hartimi i planit të punës, organizimit dhe takimeve të KI;
- Konceptimi programor e artistik i MAB;
- Ndërmarrja e veprimeve formale për themelimin e MAB, hartimin e drafteve të aktit të themelimit, statutit, rregulloreve të brendshme dhe vendimeve të tjera;
- Plani për ngritjen e strukturave të përhershme të MAB, përfshi zhvillimin e organogramit, përzgjedhjen e trupave drejtuese dhe të menaxhmentit, përcaktimin e funksioneve dhe përgjegjësive dhe të ngjashme;
- Trajtimin e çështjeve së ndërtesës së MAB, përfshirë përgatitjen e konceptit ndërtimor, arkitektonik dhe hapësinor;
- Vendosja e kornizave për ndërtimin dhe pasurimin e koleksionit të MAB;
- Detyra dhe përgjegjësi të tjera sipas nevojës dhe me kërkesë të Ministrit të Kulturës;

Që nga marsi i vitit 2022 Këshilli Inicues i Muzeut të Artit Bashëkohor deri me datën e përfundimit të këtij dokumenti (15 tetor 2022), janë mbajtur 17 takime punuese të këtij këshilli. Çështjet që janë diskutuar gjatë këtyre takimeve kanë të bëjnë me planet e punës së KIMAB, diskutime rresh këshillit konsultativ, krijimi i strukturës organizative dhe programore të MAB, diskutimet rreth lokacionit dhe ndërtesës për objektin e MAB, ideimi dhe planifikimi i Simpoziumit të KIMAB dhe çështja e koleksionit të MAB.

Disa vendime të rëndësishme nga këto takime janë si mëposhtë:

- është vendosur që formalisht të propozohet hapësira e ish-Tulltores për lokacion të objektit të MAB, e cili propozim edhe i është përcjellur ministrit Çeku nëpërmjet udhëheqësit të Këshillt, Yll Rugova;

— është vendosur që të mbahet një simpozium inicues për t'u përgjigjur disa pyetjeve fundamentale që do të ndihmojnë në ngritjen përmbajtësore të propozimit final të KIMAB për konceptin e MAB;
— është vendosur të mbahet një vizitë studimore në Holandë dhe Belgjikë me fascilitimin e organizatës Manifesta ku do të vizitohen modele të ndryshme të muzeve;

5. Legjislacioni në Kosovë

5.1 Ligjet dhe aktet nën-ligjore

Mëposhtë mund të gjeni të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me fushën e arteve pamore dhe institucioneve përkatëse të fushës.

Dokument i politikave, ligj ose akti nën–ligjor	**Lidhja me dokumentin në Gazetën Zyrtare**	**Institucioni(et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim**	**Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)**
Ligji Nr. 06/L–113 Për Organizimin Dhe Funksionimin E Administratës Shtetërore Dhe Të Agjencive Të Pavarura	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684	Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë. Ministria e Punëve te Brendshme	Të gjitha institucionet e administratës shtetërore e kanë për obligim që t'i zbatojnë dispozitat e dala nga ky ligj i cili përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kuadër ligjor për themelimin, organizimin, funksionimin, përgjegjshmërinë dhe performancën e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura.
Ligji Nr. 06/L – 114 Për Zyrtarët Publikë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25839	Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë. Ministria e Punëve te Brendshme Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë e kane për obligim që ti zbatojnë dispozitat e dala nga ky ligj i cili përcakton krijimin e bazës ligjore për punësim të zyrtarëve publikë në institucionet e Republikës së Kosovës, të bazuar në merita, integritet moral, paanësi dhe qëndrueshmëri. Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë. Ministria e Punëve të Brendshme luan rolin te rëndësishëm ne planifikimin e vendeve te punës, Ministria e Financave dhe Transfereve lejimin e planifikimit buxhetore për vende te reja te punës.

Ligji Nr. 04/L–131 Për Skemat Pensionale Të Financuara Nga Shteti	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ka për qellim rregullimin e skemës pensionale për kategori te caktuara te punëtorëve ne kuadër te MKRS duke mare parasysh qe MFPT përmes këtij ligji bënë rregullimin ne Skemën e Pensionit Bazik të Moshës, Skemën e Pensionit Kontributpagues të Moshës, Skemën e Pensionit të Aftësisë së Kufizuar dhe Skemën e Pensionit të Parakohshëm, si dhe rregullon çështjet e pensionit familjar dhe invalidor të punës, në rastet kur kontribuesit lëndohen në punë apo fitojnë sëmundje profesionale.
Ligji Nr. 03/L–048 Për Menaxhimin e Financave Publike Dhe Përgjegjësitë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524	Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë me theks te veçanet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë e kane për obligim që ti zbatojnë dispozitat e dala nga ky ligj i cili përcakton që të gjitha autoritetet publike, organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike, gjatë ushtrimit të një aktiviteti ose pranimit të një detyrimi që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përfshin ose ndikon në shfrytëzimin e parave ose burimeve publike, duhet të veprojnë në përputhje të plotë me dispozitat e këtij ligji. Asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji, si institucione mbikëqyrës është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
Ligji Nr. 05/L –020 Për Barazi Gjinore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923	Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë Agjencia për Barazi Gjinore	Të gjitha institucionet e në veçanti Agjencia për Barazi Gjinore, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.
Ligji Nr. 04/L–065 Për Të Drejtat E Autorit Dhe Të Drejtat E Përafërta	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2787	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes këtij ligji ka krijuar bazë ligjore për mbrojtjen e të drejtës së autorit që në bazë të pronës intelektuale, u takojnë autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit.
Ligji Nr. 03/L–212 i Punës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735	Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve permes ketij mbikëqyre procedurat dhe te drejtat e të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës.

Ligji Nr. 02/L–57 Për Institucionet e Kulturës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2443	Institucionet e Kulturës	Ligji për institucionet e kulturës është Ligj bazik sistemor dhe i rëndësisë së veçantë për kulturën. Me këtë Ligj rregullohen kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit të institucioneve të kulturës, karakteri, struktura organizative dhe menaxheriale e tyre, punët dhe veprimtaria, obligimet dhe përgjegjësitë, çështjet statusore, si dhe çështjet tjera për veprimtarinë dhe funksionimin e institucioneve të kulturës. 2.2. Institucioni themelohet për ushtrim të veprimtarisë kulturore, shkencore dhe artistike.
Ligji Nr. 06/L–116 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L–090 Për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18918		1. Ky ligj rregullon përkrahjen dhe mbështetjen financiare e materiale të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive përmes sponsorizimeve dhe reklamave. 2. Përmes sponsorizimit të aktiviteteve të ndryshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit realizohet interesi i përgjithshëm i cili sjell përmirësimin e jetës individuale dhe shoqërore të qytetarëve, organizatave biznesore, fondacioneve, personave fizik dhe juridik në Republikën e Kosovës. 3. Qëllimi i sponsorizimit është realizimi, përkrahja, promovimi dhe mbështetja e veprimtarive dhe aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. 4. Sponsorizimi i jepet pranuesit për implementim të interesit të përgjithshëm publik nga aktivitetet i caktuar kulturor, rinor dhe sportiv, i definuar në marrëveshjen e sponsorizimit.

Ligji Nr. 05/L –090 Për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (i ndryshuar dhe Plotësuar nga Ligji me Lart)	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13271	5. Ky ligj është në përputhshmëri me Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian (version i konsoliduar), GZ C 326/74, datë 26.10.2012, dhe me Rregulloren e Këshillit të BE –së 2015/1588 (13.07.2015) mbi zbatimin e neneve 107 dhe 108 të Traktatit mbi funksionimin e Bashkimit Evropian për kategoritë e caktuara të ndihmës shtetërore horizontale, OJ L 248/1, 24.9.2015. Neni 2 Fushëveprimi 1. Ky ligj rregullon: 1.1. sponsorizimet që ipen dhe pranohen përmes mbështetjes financiare dhe materiale në kulturë, rini dhe sport; 1.2. qëllimin e dhënies dhe pranimit të sponsorizimit; 1.3. përcaktimin e dhuruesit dhe pranuesit të sponsorizimit; 1.4. zbritje të lejuara që iu bëhen sponsorizuesve; 1.5. evidentimin dhe kontrollimin e sponsorizimeve në veprimtaritë publike dhe aktivitetet e ndryshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Neni 10 Të drejtat dhe detyrimet qe dalin nga marrëveshja e sponsorizimit 1. Përfituesi i sponsorizimit mund të jetë personi fizik apo juridik vendor i cili në emër të pranimit të sponsorizimit, duhet ti realizoj dëtyrimet të cilat dalin nga marrëveshja e nënshkruar për sponsorizim. 2. Të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshja në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën, me ligjet e Republikës së Kosovës dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat Republika e Kosovës i ka nënshkruar apo ju ka bashkuar.

Rregullore (MKRS) Nr. 01/2018 Për Përcaktimin e Kritereve, Procedurave dhe Formës për Vërtetimin e Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15916	Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kritereve, procedurave dhe formës së vërtetimit të sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, si fusha të interesit publik sipas përkufizimit të dhënë në Ligjin 05/L – 090 për Sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit si dhe në përputhje me fushat e përgjegjësisë së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Fushëveprimi Me anë të kësaj Rregulloreje do të përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta për sponsorizime në fushën e kultures, rinise dhe sportit; procedurat për lëshimin e vërtetimit mbi sponsorizimin; forma e vërtetimit të sponsorizimit; procedura e raportimit vjetor per sponsorizimin e realizuar. Neni 4 Kriteret e veçanta në fushën e kulturës 1. Përfitues te sponzorimit në fushën e kulturës mund të jenë të gjitha institucionet kulturore publike në nivel qëndror dhe lokal. 2. Përfitues të sponzorimit në fushën e kulturës mund të jenë artistët e pavarur që zhvillojne aktivitetin e tyre në kuader të organizatave jofitimrpurëse dhe biznese, asociacione kulturore joqeveritare, përfshirë festivalet të cilat zhvillojnë aktivitete kulturore në fushën e teatrit, arteve vizuale, muzikes dhe filmit. 3. Të gjithë përfituesit e sponzorimit sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të jenë të regjistruar në institucionet prkatëse të Kosovës, sipas ligjeve në fuqi që rregullojnë përkrahjen dhe mbështetjen e aktiviteteve kulturore në Republikën e Kosovës.

Rregullore Nr. 05/2011 Për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18785	Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e gradave dhe pagave të krijuesve dhe të performuesëve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore, që punojnë në institucionet e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore e që janë nën varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. 1. Fushëveprimi i Rregullores përfshinë: 1.1. Përcaktimin e institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore të cilat përfshihen në procesin e gradimit; 1.2. Përcaktimin e kritereve të gradimit; 1.3. Rregullimi i Marrëdhënies së punës; 1.4. Kategoritë funksionale të gradimit dhe pagat; 1.5. Dispozitat përfundimtare. Neni 4 Institucionet e kulturës 1. Institucionet e kulturës që krijojnë dhe përformojnë art dhe kulturë janë: 1.1. Teatri Kombëtar i Kosovës; 1.2. Baleti Kombëtar i Kosovë 1.3. Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve “Shota ”; 1.4.Filharmonia e Kosovës; 1.5. Galeria Kombëtare e Kosovës; 1.6. Kosovafilmi; 1.7. Qendra Kinematografike e Kosovës. Neni 18 Pagesat shtesë mbi pagën bazë 1. Format tjera të pagesave shtesë bëhen sipas dispozitave përkatëse të Ligjit të Punës nr. 03/L–212. 2. Krijuesit, performuesit e kulturës dhe punonjësit profesional të trashëgimisë kulturore, nuk kanë të drejtë të përfitojnë kompensim shtesë për punën e tyre që nuk kanë baza ligjore në Ligjin e Punës nr. 03 / L212. Neni 20 Rregullimi i marrëdhënies së punës 1. Punëtorët që i përkasin kategorive të përcaktuara me këtë rregullore, të cilët kanë pas të rregulluar marrëdhënien e tyre të punës me Ligjin Nr. 03 /L–149 për Shërbimin Civil, për të përfituar pagë sipas kësaj rregulloreje duhet të heqin dorë vullnetarisht nga statusi i shërbyesit civil. 2. Punëtorët të cilët heqin dorë nga Statusi i Shërbyesit Civil lidhin kontratë të re të punës me MKRS-në bazuar me Ligjin Nr. 03/L–212 i Punës, në cilësinë e njërës nga kategoritë e përcaktuar me këtë rregullore. 3. MKRS obligohet të lidh kontratë brenda 30 dite pune, me të gjithë kategoritë e rregulluara me këtë rregullore.

6.
KONTEKSTET E ARKITEKTURËS

6. Kontekstet e arkitekturës

6.1. Konteksti hapësinor

Propozimet për lokacionin e Muzeu i Artit Bashkëkohor të Kosovës Rilindja kanë derivuar pas analizës së faktorëve kryesor që ndikojnë në planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm urban dhe ekonomik. Parametrat kyç dhe parashikues për planifikimet e zhvillimit të një vendi apo qyteti janë nataliteti, imigrimi dhe emigrimi i popullësisë, gjë që ndikon në mënyrë direkte në zhvillim ekonomik të vendit. Duke konsideruar këto parametra dhe bazuar në normat e planifikimit hapësinor, është arritur në përfundim që lokacioni për një institucion si MABK, i cili do të ishte më i suksesshëm, i qasshëm, i qëndrueshëm, dhe më i favorshëm do të ishte kryeqyteti i Prishtinës.

Meqë muzetë zakonisht luajnë rol të rëndësishëm në aspektin urban, lokacioni i MABK në kuadër të qytetit varet shumë nga tipi i muzeut që vizionojmë të ndërtojmë, si në aspektin funksional, konceptual, dhe arkitektonik. Pas shumë diskutimeve të Këshillit Inicues të MABK, ekspertë të arkitekturës dhe urbanizmit, ekspertë të fushës së artit dhe kukturës, kemi ardhur deri te vendimi që ish-shtypëshkronja Rilindja të përvetësohet si ndërtesë për MABK. (*Fig.1—Muzeu në kuadër të qytetit*)

Gjatë planifikimit hapësinor është e zakonshme që muzetë dhe galeritë të përdoren si stimuj për të ndihmuar në rigjenerimin e zonave të degraduara të qytetit, për t'i shtuar vlerë lokacionit, për të tërhequr vizitorët ose për të inkurajuar përdorimin e tyre si hapësira për të kaluar kohën e lirë dhe në këtë mënyrë duke i bërë pjesë më aktive të qytetit. Kjo arrihet përmes një planifikimi të mirë duke krijuar një vizion të qartë lidhur me lokacionin dhe ndërtesën në kontekstin urban.

Gjatë konceptualizimit, faktorët që do të udhëzojnë apo kufizojnë si në planifikim apo zhvillim të aktiviteteve të një muzeu janë faktorët urbanë, gjegjësisht parimet urbane të dizajnit kontekstual. Planifikimi urban i dizajnit kontekstual bazohet në parimet si:

- Rigjenerimi urban;
- Ndikimi në zhvillimin ekonomik të zonës;
- Ndikimi i zhvillimit urban në atë shoqëror;
- Qasshmëria;
- Komunikacioni;
- Shtigjet e bicikletave;
- Reduktimi i përdorimit të automobilëve;
- Reduktimi i numrit të parkingjeve;
- Lokacioni i pështatshëm për mjedis, prezenca e ujit dhe gjelbërimit;
- Qasja e lehtë për këmbësorë;
- Krijim të komunitetit të hapur dhe të qasshëm;

Sipas konfigurimit të tij, lokacioni në raport me ndërtesat që ka përreth dhe madhësisë së sipërfaqes së ndërtesës, kërkohet që të mundësohet qasja sa me e shkurtë apo e lehtë në MABK, duke mos i obliguar vizitorët që të sillen përreth parcelës deri tek një hyrje. Kjo mendohet të arrihet përmes trajtimit të hapësirës përreth duke e dizajnuar në formë platforme artistike dhe platformës rekreative (*Fig. 2—Pikat atraktive në kuadër të lokacionit*), dhe duke krijuar hapësira dhe shtigje që të orientojnë nga të gjitha anët përreth parcelës drejt ndërtesës së ish-shtypëshkronjës Rilindja/ MABK.

Transformimi i hapësirës së jashtme mundëson lidhjen me blloqe dhe ndërtesa tjera perreth dhe qytetin në tërësi. Transformimi i kësaj hapësire në oaza të gjelbërta, duke krijuar një seri hapësirash shoqërore fleksibile fton vizitorët, audiencat dhe komunitetet afër muzeut, qoftë edhe vetëm kalimthi.

Kompleksi i ish-Rilindjes është i pozicionuar në afërsi të qendrës së qytetit, zonë kjo e cila është urbanizuar mes viteve '70 dhe '80, dhe ka mbetur e tillë me një infrastrukturë të planifikuar mirë. Prandaj, këto parakushte e bëjnë këtë ndërtesë lehtë të qasshme dhe të përshtatshme për të gjitha kategoritë e qytetarëve, edhe pse kjo zonë nuk ka pasur ndonjë regjenerim apo ndryshim të planit urban që nga vitet kur është urbanizuar fillimisht.

Në të njëjtën zonë ndodhet edhe Pallati i Rinisë dhe Sporteve, Muzeu i Burgut të Prishtinës, dhe së fundi është paraparë edhe lokacioni për ndërtimin e sallës së Operës dhe Baletit. Afërsia mes

Fig.1—Muzeu në kuadër të qytetit



Fig. 2—Pikat atraktive në kuadër të lokacionit

këtyre institucioneve me MABK në konstelacion, ka potencialin të krijojë ringjallje urbane dhe kulturore të kësaj zone. Një mjedis i tillë, i përqëndruar në kulturë e rini, ka për qëllim sendërtimin e një imazhi të ri kulturor për Kosovën. (*Fig. 3—Konteksti urban kulturor*)

Lokacioni i kompleksit Rilindja shtrihet në bllokun urban Lakrishte. Linjat e komunikacionit, si për biciklistë apo autobusë janë përgjatë këtij kompleksi dhe këto mundësojnë lidhjen me të gjitha lagjet e kryeqytetit duke përdorur trafikun urban apo edhe në këmbë. Në afërsi të kompleksit Rilindja është edhe stacioni i trenit që mundëson një qasje të lehtë edhe nga qytetet tjera që lidhen me transportin hekurudhor. (*Fig. 4—Komunikacioni dhe qasjet*)

Kompleksi Rilindja përfshinë rreth 50,000 m² të sipërfaqes së parcelës në të cilën janë: Kulla e cila shfrytëzohet nga dy Ministritë, ajo e MPB-së dhe MMPH-së, si dhe ndërtesa e ish shtypëshkronjes e cila është përzgjedhur për Muzeun e Artit Bashkëkohorë të Kosovës. Kjo e fundit momentalisht shfrytëzohet rreth 30 % nga AKP-ja, ndërsa pjesa tjetër është e pashfrytëzuar.

Zona përreth kompleksit Rilindja është e planifikuar sipas normave të planifikimit hapësinor dhe ende ka ruajtur ato veçori urbane, dhe falë vlerave arkitektonike, kulturore dhe historike të Rilindjes, ajo konsiderohet monument urban dhe është në mbrojtje nga MKRS. Ky monument reflekton zhvillimin e arkitekturës brutaliste, duke e transferuar kujtesën historike dhe shoqërore nga breza të mëparshëm tek brezat e ri.

6.2. Konteksti arkitektonik

Komplesi Rilindja është projektuar nga arkitekti Georgi Konstantinovski, i cili ishte i njohur për projektet e tij arkitekturore në stilin *brutalist*. Ndërtesa e ish-Rilindjes e ndërtuar në vitet '70-ta, ka një vlerë të veçantë të trashëgimisë arkitekturore dhe përfaqëson një periudhë të rëndësishme të zhvillimit të modernizmin dhe brutalizmin në vend, dhe si e tillë duhet të ruhet. Nisur nga këto vlera arkitektonike, MKRS e ka vënë në listën e monumenteve për mbrojtje të përkohëshme kështu duke e konsideruar aset me vlerë të trashëgimisë arkitekturore dhe historike.

Gjatë 20 viteve të fundit, ndërtesa e ish shtypëshkronjës është shfrytëzuar për funksione të ndryshme. Ndryshimi i funksioneve të ndërtesës ka shkaktuar dëmtime të konsiderueshme strukturore dhe të fasadës. Prandaj muzeu në Rilindje ka potencial që ta ruaj më së miri të kaluarën e trashëguar të këtij monumenti me rëndësi shtetërore, duke dashur të ndërtojë mbi të kaluarën e saj dhe t'i mundësojë jetesë me reflektime kritike në të ardhmen.

Ndërtesa është projektuar për t'u shfrytëzuar për nevojat e shtypit të shtëpisë botuese dhe gazetës Rilindja. Ndërtesa e ish Rilindjes përfshinë sipërfaqe totale ndërtimore me rreth 25,500 m² (shtypëshkronja me rreth 24000 m² dhe ndërtesa paralel me kullën me rreth 1,500 m². Për shkak të funksionit të saj të mëparshëm, disa hapësira në Rilindje kanë lartësi deri ne 14 metra e cila mundëson adaptimin e funksioneve të ndryshme në të.

Parametrat konstruktiv të ndërtesës ish-Rilindja i përgjigjen Muzeut të Artit Bashkëkohor duke i mundësuar adaptimin për funksione të reja si: hapësirat ekspozuese, arkiv, hapësira për restaurim dhe konservim, amfiteatër, librari, restorane, kafiteri dhe funksione tjera përcjellëse të një muzeu. Intervenimi gjatë adaptimit duhet të bëhet konform vlerësimeve dhe rekomandimeve apo raporteve për shkallën e intervenimit në strukturën ekzistuese nga QRTK Prishtinë dhe MRKS – Departamenti i Trashëgimisë Kulturore.

Ky intervenim në ish-shtypshkronjën Rilindja mundëson rikthimin e një strukture historike në funksion përmes institucionit të MABK-së. Ky intervenim duhet të synojë ruajtjen e integritetit të ndërtesës duke inkorporuar propozimet arkitekturore që reflektojnë karakterin historik dhe kulturor, duke e bërë funksionale dhe të përdorshme për MABK dhe akterë të tjerë.

Intervenimet në ndërtesa ekzistuese apo monumente kulturore trajtohen me shumë kujdes, dhe poashtu gjatë analizës së kësaj ndërtese për MABK janë konsideruar faktorët që ndikojnë dukshëm në konceptin arkitektonik:

- Krijimi i një imazhi të ri kulturor;
- Shfrytëzimi i hapësirave dhe sipërfaqeve ekzistuese;
- Fleksibiliteti në funksion;
- Benefitet e qytetit nga MABK;

- Benefitet e qytetarëve nga MABK;
- Ndikimi në kualitetin jetësor të qytetarëve;
- Aspekti politik, social dhe kulturor;
- Argëtimi, kultura dhe biznesi;
- Vizibiliteti/ atraktiviteti;
- Identiteti arkitektonik;
- Ndryshimet shoqërore;

Në aspektin konceptual, në një ndërtesë si aneksi i ish-Rilindjes, MABK do të merrte mbi supe jo vetëm koleksionimin dhe ekspozimin e artit bashkëkohor, por gjithsesi do të shërbente si projekt flamurtar në fushën e trashëgimisë kulturore, duke shërbyer si një bërthamë qëndrore për gjithë trashëgiminë e lëvizshme të vendit, përfshirë krijimin e kuadrove profesionale, arkivimin, konservimin dhe riparimin e eksponateve nga koleksionet e ndryshme të vendit.

MABK Rilindja do të shërbejë si një bërthamë përbashkuese hibride për iniciativat burimore të kulturës që në një mënyrë ose tjetrën aktivitetin e kanë të ndërlidhur me aneksin e ish-Rilindjes. Që nga themelimi i saj, Rilindja ka qenë një vend ku narrativat historike krahasohen, kundërshtohen, kontestohen dhe ndërthuren, dhe kjo praktikë do të vazhdoj edhe më tutje përmes formave të ndryshme të artit bashkëkohor.

Në aspektin funksional, ndërtesa sipas shtrirjes së saj horizontale mbulon një sipërfaqe të madhe me shputën e saj, prandaj për të mundësuar qasje më të lehtë nga pjesa jugore e parkut në atë veriore që orienton kah Iokacioni i Sallës së Operës dhe Baletit, duke paraparë (por jo domosdoshmërisht e obligueshme) penetrim përmes ndërtesës. Kjo njëkohësisht mundëson aksesin më të dukshëm në ndërtesë nga të dy anët dhe po ashtu ndarjen e integruar të entiteteve operuese si Hapësirës dhe Arkivi Rilindja nga MABK Rilindja, mirëpo gjithmonë duke pasur parasysh lidhjen mes funksioneve, lidhjeve/ komunikimit horizontal dhe vertikal të muzeut si dhe sigurinë e ndërtesës në tërësi. (*Fig. 5—Qasshmëria në ndërtesë*)

Hapësirat ekspozuese të jenë të dukshme nga ambientet e jashtme për aq sa e lejon arkitektura dhe intervenimi, ky ndërveprim qoftë edhe vetëm vizuel mund të ketë efekt në intrigimin dhe nxitjen e kurreshtjes tek kalimtarët për të vizituar muzeun. Kjo është një ndër mënyrat e afrimit të qytetarëve të rastit me artin. Kjo mënyrë e planifikimit, sidomos trajtimi i hapësirës publike përreth ndërtesës krijon dhe mundëson vizibilitet të MABK në kuadër të lokacionit duke e vënë atv në qendër të vëmendjes.

6.3. Konteksti ndërtimor

Parimi i cili duhet të respektohet gjatë ridizajnimit/ rifunksionalizimit të kësaj ndërtese është ai i adaptimit i përcjellur me faktorët e ndërtimit të një mjedisi efiçient dhe të qëndrueshëm.
Për performim më të mirë të ndërtesës së muzeut është e domosdoshme që të plotësohen standardet kryesore si në pikat në vijim:

- Qasjet sa me të lehta dhe të dukshme në ndërtesë;
- Lehtësimi i aksesit për persona me aftësi të kufizuara;
- Sigurimi nga zjarri;
- Izolimi i duhur i zërit dhe parandalimi i zhurmës;
- Kriteret e qëndrueshmërisë së strukturës dhe efiçienca termike e ndërtesës;
- Sigurimi dhe preventimi nga vjedhjet dhe vandalizimi;
- Sigurimi i hyrje daljeve;

Adaptimi i ndërtesës gjatë rifunksionalizimit mund të përkufizohet si një ndërhyrje për të përshtatur, ku çdo intervenim bëhet mbi synimin që të arrihen ndryshime në mirëmbajtje, kapacitet, funksion dhe performancë më të mirë të ndërtesës.

Struktura e ndërtesës së ish shtypëshkronjes Rilindja ka konstruksion masiv skeletor mbajtës në disa hapësira dhe konstruksion kaseton meskatesh në hapësira tjera, e cila është projektuar si e tillë për të fituar hapësira fleksibile me distanca të mëdha pa shtylla. Një sipërfaqe e Rilindjes ka konstruksion hapësinore kapriate të metalit e cila arrin lartësi të hapësirës deri në 12.60 m lartësi dhe mundësia e krijimit të një hapësire deri në 14.80 m lartësi. (Këto lartësi duhet të matet saktësisht dhe të definohet gjatë përgatitjes së projektit për konkurs apo adaptim pasi që i referohen projektit nga arkiva).



Fig. 3—Konteksti urban kulturor

Muzeu Etnologjik
Stacioni CCA
Rr. Iljaz Agushi
Galeria 17
Hammami
Rr. Agim Ramadani
Muzeu Kombëtar i Kosovës



Fig. 4—Komunikacioni dhe qasjet



Fig. 5—Qasshmëria në ndërtesë

Implementimi i projektit dhe renovimi i ndërtesës së Rilindjes për MABK është paraparë të realizohet në katër faza:

- **Faza e parë —** është fazë e adaptimit të ndërtesës që ka për qëllim akomodimin e stafit të MABK-ës në hapësirat siç janë të paraqitura në (*Fig. 6—Fazat e implementimit*). Hapësira e ndërtesës sipas *Fig. 6* të përgatitet për shfrytëzim përmes një intervenimi minimal të përkohëshëm për akomodimin e stafit të MABK. Përdhesa dhe kati i parë është menduar të shfrytëzohet përkohësisht për ekspozita të përkohshme, ndërsa kati i dytë do të shfrytëzohet për akomodimin e përkohshëm të stafit të MABK. Përgaditja e ndërtesës për shfrytëzim të zgjasë 6–12 muaj duke përfshirë projektin ideor me paramasë dhe parallogari.

- **Faza e dytë —** analiza e ndërtesës përmes Raportit të Fizibilitetit në të cilin përfshihen të gjithë ekspertët e fushës: si kuratorë dhe udheheqës me përvoje në institucione të muzeut të artit, arkitektë me eksperiencë në projektim të muzeve të artit ku elaborohen më në detaje kërkesat për një muze sipas konceptit të vizionuar nga KIMAB. Në këtë proces të përfshihen poashtu inxhinierë të ndërtimit për vlerësimin e gjendjes së strukturës së ndërtesës, inxhinierë të makinerikës me përvojë në zgjidhje të ventilimeve për ndërtesa/funksione të tilla, eskpertë të ndriçimit dhe zërimit, ekspertë të efiçiencës në ndërtim përmes të cilëve përcaktohen kriteret e qëndrueshmërisë varësisht nga buxheti i mundshëm për realizimin e këtij projekti. Nëse synohet të aplikohet për fonde ndërkombëtare të analizohen kriteret të cilat duhet të plotësohen apo të parashihen për ndërtesa të tilla para aplikimit, pasi që janë kusht për të fituar mbështetje financiare. Në këtë proces poashtu të përfshihen edhe akterë tjerë të mundshëm për të diskutuar edhe nevojat e tyre dhe definimin e hapësirave për interesat e tyre. Në këtë fazë fakultetet e arkitekturës mund të konsiderohen si forcë shtytëse teknike dhe kreative të cilët mund të përfshihen gjatë këtij procesi të hulumtimit, analizës dhe zhvillimit të skenarëve të ndryshme të potencialit të hapësirës së Rilindjes.

- **Faza e tretë —** përgatitja e konkursit ndërkombëtar dhe përzgjedhja e projektit më të mirë nga juria e konkursit.

- **Faza e katërt —** realizimi i projektit të përzgjedhur nga konkursi ndërkombëtar për ndërtesën e ish shtypëshkronjës Rilindja.

(*Shih kapitullin 11, faqe 61→*)



Fig. 6—Fazat e implementimit (faza 1 dhe 2)

7.
PROGRAMI DHE FUNKSIONET

7. Programi dhe funksionet

a. Synimi i MABK-së

MABK do të jetë një platformë kulturore transformuese për artistët, publikun dhe komunitetet e ndryshme, duke ofruar hapësirë për eksperimentim, shprehje artistike, reflektim dhe dialog. Thelbi i programit të muzeut është besimi i palëkundur në fuqinë transformuese të artit. Programet do të reflektojnë një spektër të gjerë zërash dhe perspektivash lokale dhe ndërkombëtare, të përkushtuara tërësisht për të siguruar që ato të krijojnë një spektër të gjerë audiencash. Përmes iniciativave të shumta si pjesë të programit publik, muzeu do të punojë drejt thyerjes së barrierave kulturore, duke e bërë artin të qasshëm për audiencat dhe komunitetet e ndryshme që jetojnë në Kosovë. Duke përqafuar vlerat e gjithëpërfshirjes, muzeu do të krijojë një ambient ku arti bëhet një përvojë demokratike që promovon barazinë.

MABK synon kurimin e ekspozitave rreth çështjeve që shpërfaqin kontekste të pasura kulturore, shoqërore, politike dhe më gjerë. Promovimi i diversitetit, barazisë dhe gjithëpërfshirjes në MABK, do të sigurohet përmes programit në formate të ndryshme ekspozuese dhe botuese. Pavarësisht nga prapavia kulturore, identitare apo aftësive, të gjithë do të kenë mundësi të barabartë për t'u angazhuar dhe kontribuar në programin publik të kuruar brenda mureve të muzeut.

MABK synon të kultivojë një mjedis që përqafon dhe përfaqëson perspektivat e ndryshme, ndihmon përfshirjen dhe sfidon praktikat diskriminuese, duke u bërë një katalizator për ndryshime pozitive shoqërore. MABK do të përpiqet që të krijoj një mjedis ku secili/a do të ndihet i mirëpritur, i respektuar dhe i përfaqësuar. Ky parim niset nga mendësia se një përvojë artistike mund të arrihet vetëm duke njohur shumëllojshmërinë e zërave, perspektivave dhe përvojave që janë të pranishme në shoqëri.

b. Qëllimi i MABK-së

MABK mëton të jetë pjesë integrale e një rrjeti artistik global, duke bashkëpunuar me institucione, kuratorë dhe kritikë të njohur, do të krijoj një platformë për dialog ndërkombëtar dhe do të promovoj shkëmbimin ndërkulturor. MABK do të organizojë ngjarje si biseda me artistë, rezidenca, punëtori dhe performanca për të angazhuar publikun dhe komunitetin në një dialog për artin bashkëkohor dhe çështje të ndryshme. Edukimi është qendror në përpjekjet e këtij institucioni të u shërbejë artistëve, audiencave dhe komuniteteve të ndryshme. MABK është e përkushtuar të kultivojë gjenerata të ardhshme të artistëve dhe ngritë cilësinë e artit bashkëkohor. Kjo do të arrihet përmes programeve edukative të përshtatura për grupe-mosha të ndryshme, ndërveprimit me komunitete të ndryshme dhe në partneritet me institucione arsimore. MABK do të thyej kufijtë e hulumtimit artistik, duke përqafuar formate të ndryshme ekspozuese dhe kërkuese. Qëllimi është që ky institucion të rimendojë rolin e artit në shoqëri dhe të promovojë fuqinë transformuese të saj.

7.1. Administrata

Zyrat mund të kenë plan të hapur, me një zonë pune qendrore që është e lehtësisht e qasshme për të gjithë anëtarët e stafit. Hapësira duhet të jetë fleksibile, duke lejuar rikonfigurim dhe adaptim të lehtë nëse nevojat e muzeut ndryshojnë me kalimin e kohës. Ambienti komod në hapësirat ku drita natyrale të jetë prioritet, të inkorporohen në dizajn për të siguruar ndjenjë natyrale të mjaftueshme në të gjithë hapësirën. Kjo jo vetëm do të përmirësojë atraktivitetin vizual të zyrës, por gjithashtu do të nxisë produktivitetin dhe një ndjenjë të mirëqenies midis anëtarëve të stafit. Dizajni i zyrës duhet të inkorporojë elementë artistikë që reflektojnë misionin e muzeut dhe fokusin në artin bashkëkohor. Kjo mund të përfshijë një seleksion të kuruar të veprave të artit në shfaqje ose instalime artistike që krijojnë një atmosferë unike dhe frymëzuese. Për çdo projekt arkitekturor të hapësirave të punës, koncepti duhet të përqendrohet në funksionimin e hapësirës, që të jetë e qëndrueshme dhe e kreative. Hapësirat e zyrave do të përdoren për administrimin e përgjithshëm të muzeut, si dhe për koordinim të ekspozitave të reja dhe promovimit të aktiviteteve të ndryshme.

Koncepti gjithashtu do të sigurojë privatësi dhe siguri për stafin, si dhe për vizitorët që mund të kenë nevojë të vizitojnë hapësirat e administratës.

a. Qasja, hyrja dhe pranimi
Qasja në ndërtesën e MABK-së duhet të përçojë një mesazh të mirëseardhjes. Nga fillimi duhet komunikuar që kemi të bëjmë me një ndërtesë të një institucioni të veçantë, më konkretisht të një muzeu të artit. E karakterizuar nga prania e artit dhe një mjedisi që është ndryshe nga norma, arkitektura, peizazhi dhe planifikimi urban duhet komunikojnë në të njëjtën frymë. Duhet të ketë një ndjenjë transparence në lidhje me misionin dhe programin e muzeut, duke u ofruar vizitorëve sugjerime vizuale të shumëllojshmërisë të muzeut si thesar, si ngjarje dhe si vend me ofertë kulturore. Kjo duhet të jetë e dukshme qysh në hyrje, për të kaluar në atë që ndodh brenda në MABK.

b. Foajeu, lobi, eksperienca dhe shërbimet e vizitorëve
Ndërtesa duhet të ofrojë një mundësi për të forcuar lidhjet me komunitetin artistik dhe të tërheqë vizitorë të rinj dhe të ndryshëm nga e gjithë Kosova. Në përputhje me një paradigmë bashkëkohore muzeale, vizitorët duhet të ndjejnë gjithashtu praninë e komunitetit — që muzeu i shërben komuniteteve. Prandaj, duhet të siguroj një përvojë të pasur dhe ndjenjë të mirëseardhjes dhe rehatisë, duke demonstruar fuqinë dhe rolin që mund të luajë arti në kontekstin më të gjerë shoqëror. Muzeu duhet të sigurojë të gjitha elementet e një hapësire mikpritëse, si kafiteria, restorani, dyqani i muzeut dhe programe arsimore dhe ngjarje të veçanta. Kafiterinë, dyqanin dhe hapësirat e ngjarjeve programatike u ofrojnë vizitorëve një mundësi për kontakt joformal, por kuptimplotë me artin, artistët dhe studiues të artit.

7.2. Hapësirat publike të jashtme dhe të brendshme

7.2.1. Galeritë dhe hapësirat e artit

Eksperienca e galerisë është mjeti kryesor me të cilin MABK i shërben misionit të saj dhe arrin të përmbush visionin e saj. Përvojat që galeritë ofrojnë duhet të udhëzohen nga këta faktorë:

a. Ndërtesa e Rilindjes duhet transformuar për të krijuar hapësira ekzposuese brenda strukturave të saj;

b. Këto hapësira duhet të akomodojnë programe publike që akomodojnë aktivitete edukative dhe kërkimore, si dhe ekspozita të kompleksitetit të shkallëve të ndryshme;

Hapësirat e MABK-së do të ofrojnë mundësi për të pranuar informacione dhe për të komunikuar një narrativë, duke përqafuar idenë se historia e artit është gjithnjë në zhvillim dhe se ky parim duhet të manifestohet në galeritë që ndryshojnë në vazhdimësi. Hapësirat duhen te shërbejnë për qëllime të rëndësishme, por ajo që do të kërkohet është një frymë aventuriere ose guximi mes kuratorëve dhe edukatorëve për t'u angazhuar plotësisht me narrativa komplekse, të nuancuara, dhe që ngërthejnë në vete pyetje karshi shoqërisë dhe kontekstit të gjerë.

Për më shumë detaje sa i përket galerive të muzeut dhe aktiviteteve programatike, shih kapitullin 10 — Departamentet dhe Organogrami, pika 1.2., faqe 50 →

7.2.2. Hapësirat e destinuara për arkiv dhe konservim të koleksioneve

Hapësirë e konservimit dhe mirëmbajtjes të koleksionit të përhershëm: Qëllimi kryesor i hapësirës së konservimit dhe mirëmbajtjes është të sigurojë një mjedis të përshtatshëm për veprat e aritit dhe materialet arkivore, duke garantuar ruajtjen e tyre në të ardhmen. Në këtë mënyrë, koleksioni dhe arkivi i muzeut do të shërbejë si burim i pasur për studiuesit, studentët, vizitorët dhe të gjithë ata që janë të interesuar në trashëgiminë kulturore.

7.2.3. Bashkëpunimi dhe ndëveprimi me entitete të tjera

a. Arkivi Rilindja — Infrastruktura e kujtesës së ndërtesës të muzeut
Kjo hapësirë do të jetë ndryshe nga çdo hapësirë ekzistuese në MABK, duke treguar qartë në hyrje se hapësira paraqet pasqyrim historik te ndërteses. Iniciativat e mbledhjes së arkivit të Rilindjes do të integrohen për të krijuar sinergji të re në shpërfaqjen e historisë së ndërtesës dhe institucionit më të rëndësishëm kulturor që ka funksionuar aty.

b. Hapësira — programi i natës
Ndërtesa e shtypshkronjës së Rilindjes ka shërbyer një kohë të gjatë edhe si hapësirë e muzikës, veçanërisht asaj elektronike, duke krijuar kështu një traditë në këtë drejtim. Muzeu do të integroj në strukturat e saj programatike të gjitha iniciativat paraprake, duhe i mbështetur ato në realizimin e formateve të tyre kulturore. MABK do të ketë programin e natës që do të përfshijë edhe program të muzikës, si dhe program të kombinimit të muzikës elektronike me programin e arteve pamore.

7.3. Hapësirat publike të jashtme dhe ato të brendshme

a. Biblioteka
MABK do të ketë një bibliotekë unike dhe e pasur me libra, revista dhe literaturë të të gjitha fushave të artit, kritikës, shkencave shoqërore dhe të filozofisë të botuara ne Kosovë dhe jashtë saj. Shtëpia botuese Rilindja luajti një rol të rëndësishëm në ngritjen intelektuale të Kosovës, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, ku shkalla e analfabetizmit ishte i lartë, dhe botimet e saj promovonin qasje të hapur në medie të shkruara. Shtëpia botuese dhe publikimet e saj kanë luajtur një rol kritik në ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit. Andaj, ruajtja e historikut të shtëpisë botuese Rilindja si pjesë e strukturës së përhershme të muzeut është një mënyrë për të ruajtur këtë referencë të kujtesës së institucioneve kulturore.

Biblioteka do të vendoset në një hapësirë të dedikuar përbrenda muzeut, e cila duhet të jetë lehtësisht e qasshme nga vizitorë. Biblioteka do të përfshijë një gamë të gjerë burimesh origjinale për artin bashkëkohor, historinë e artit dhe teorinë dhe kritikën e artit. Biblioteka do të dizajnohet për të ofruar një hapësirë të rehatshme dhe ftuese për vizitorët për të lexuar dhe mësuar. Kjo mund të përfshijë ulëse të rehatshme, tavolina dhe ndriçim që është i përshtatshëm për të lexuar. Hapësira mund të përfshijë gjithashtu burime multimediale, si një ekran ose projektor për të shfaqur filma ose ekspozita në formatin dixhitale. Një katalog i bibliotekës duhet të jetë në dispozicion për vizitorët online ose fizik. Ky katalog mund të jetë i kërkueshëm online dhe i përditësuar rregullisht me titujt e ri në bibliotekë.

b. Auditoriumi dhe teatri
Duke kombinuar këto dy hapësira, do të krijohet një ambient i veçantë për artet vizive që mund të përshtatet për një gamë të gjerë ngjarjesh, nga koncertet dhe ligjëratat deri në produksionet teatrale dhe shfaqjet live të tjera. Kjo hapësirë mund të shfrytezohet për ngjarje të ndryshme performative. Është e rëndësishme që aktivitetet të ndodhin në orë të ndryshme dhe në ditë të ndryshme të javës, në mënyrë që të mos ndodhë përplasje midis programit të teatrit dhe programit të auditoriumit. Me këto kushte është e mundur që teatri dhe auditoriumi të zhvillojnë aktivitetet e tyre në të njëjtën hapësirë të përbashkët në ndërtesën e MABK-së.

c. Restorani dhe kafiteria
Restorani dhe kafiteria duhet të dizajnohen duke u nisur nga një qasje restauruese që integrojnë veçoritë arkitekturore të ndërtesës së Rilindjes dhe ruajnë trashëgiminë e saj. Dizajni duhet të marr në konsideratë pikat e mëposhtme:

1. Fleksibiliteti: Hapësira duhet të jetë e përshtatshme që të akomodojë shër-

bime të ndryshme, si ato ushqimore, shitëse, ashtu edhe ambiente të lira në stil kafiterije;
2. Estetika: Dizajni i brendshëm duhet të jetë i këndshëm dhe të harmonizojë me atmosferën artistike të muzeut, duke përfshirë elemente bashkëkohore;
3. Funksionaliteti: Planifikimi duhet të lehtësojë operacionet e shërbimit, duke siguruar lëvizje të lehtë për stafin dhe qasje të lehtë për vizitorët;
4. Ushqyerja jashtë: Kur është e mundur, duhet të ofrohet edhe hapësira e ushqyerjes jashtë, duke i ofruar vizitorëve mundësinë të shijojnë mjedisin që i rrethon;

7.4. Hapësirat teknike

Kthina e mirëmbajtjes së ventilimit (përcaktohet nga inxhinierët e ngrohjes sa njësi/ kthina varësisht nga kapaciteti i pajisjes). Kthina për stafin teknik dhe mirëmbajtjes dhe sanitaritë (varen nga organizimi i hapësirave tjera të muzeut).

7.4.1. Standardet e dizajnit

a. Qasshmëria
Dizajni i projektit duhet të përmbushë Aktin për Personat me Aftësi të Kufizuara të Kosovës. Kjo do të thotë që projektin duhet të dizajnohet në mënyrë që siguron qasje për persona me aftësi të kufizuara, përfshirë përdoruesit e karrocave, me probleme me të pamurit dhe dëgjimit. Dizajni duhet të konsiderojë karakteristikat si parkim i qasshëm, rampa, ashensorë, dysheme, shenjëzim me alfabetin brail dhe sisteme zinxhirë dëgjimi. Dizajni i projektit duhet të priorizojë përdorimin e materialeve të rinovueshme dhe jo-toksike, dritave, ngrohjes dhe sistemeve të ftohjes efikase në konsumin e energjisë. Dizajni i projektit gjithashtu duhet të konsiderojë përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.

b. Qëndrueshmëria
Dizajni i projektit gjithashtu duhet të priorizojë qëndrueshmërinë duke përfshirë praktikat e dizajnit qëndrueshëm. Kjo do të thotë që duhet të konsiderojnë masa që do të zvogëlojnë kostot operative ditore të vendit në krahasim me kostot e ndërtimit të parë. Dizajni i projektit duhet të konsiderojë përdorimin e ventilimit natyral, dritave dhe pajisjeve me efikasitet të lartë, pajisjeve me efikasitet të lartë të ujit, dhe masa të tjera që do të zvogëlojnë konsumin e energjisë dhe ujit të vendit.

7.5. Parku i Rilindjes

Propozimi për krijimin e një parku dhe peizazhi të ri rreth Rilindjes, ka për qëllim të përmirësojë ambientin e muzeut dhe të krijojë një hapësirë të re dhe të mahnitshme për vizitorët. Krijimi i një peizazhi të mbushur me gjelbërim, pemë, lule dhe elemente natyrore të tjera do të krijojë një atmosferë relaksuese dhe të frymëzuar nga arti. Bimët mund të përfshijë një kombinim të specieve të natyrshme dhe të huaja, të zgjedhura me kujdes për të krijuar një ambient vizualisht interesant të ngjyrave, teksturave dhe formave.

Kjo hapësirë e re do të shërbejë si një vend ku vizitorët mund të pushojnë, të reflektojnë dhe të gëzojnë bukurinë e natyrës. Gjithashtu, një park i mirëmbajtur do të sjellë avantazhe të tjera për muzeun. Aty mund të organizohen aktivitete artistike, si performanca, ekspozita jashtë, instalime artistike të përkohshme në hapësirat e hapura në park. Kjo do të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit për artin dhe kulturën në komunitetin tonë dhe audiencave që preferojnë ambientet e hapura me programe kulturore.

7.6. Oborri brendshëm

Oborri i brendshëm gjendet në qendër të ndërteses ku është paraparë akomodimi i MABK-së. Në këtë oborr mund të zhvillohen aktivitete të ndryshme si promovime të librave apo aktivitete të muzikore për një numër të caktuar të njerëzve. Në këtë oborr duhet të ruhen drunjtë që ekzistojnë dhe të projektohet gjithmonë duke i pasur parasysh prezencën e tyre. Për të mundësuar lidhjen e kësaj ndërtese me atë të ekspozitave mund të parashihen ura lidhëse nepër apo mbi këtë oborr që të mundësohet fleksibiliteti në funksion dhe efikasiteti i lëvizjes prej një hapësire në tjetrën.

8.
STATUTI I MUZEUT TË ARTIT BASHKËKOHOR TË KOSOVËS

MABK RILINDJA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladina i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

STATUTI I MUZEUT TË ARTIT BASHKËKOHOR TË KOSOVËS
RILINDJA

Këshilli Inicues për Themelimin e Muzeut të Artit Bashkëkohor

Bazuar në Artikullin X të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në ndërlidhje me Ligjin për Art dhe Kulturë, seksioni XX, YY, ZZ në lidhje me themelimin e Muzeut të Artit Bashkëkohor, Ministri/ja i/e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me anë të këtij dokumenti vendos mbi statutin e Muzeut të Artit Bashkëkohor të Kosovës.

Nxjerrë:

STATUTIN E MUZEUT TË ARTIT BASHKËKOHOR TË KOSOVËS
RILINDJA

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Statut, rregullohet veprimtaria, mënyra e financimit, misioni dhe vizioni si dhe kompetencat e organeve drejtuese të Muzeut te Artit Bashkekohor të Kosovës, (në tekstin e mëtejmë të MABK), në funksion të kryerjes me sukses, të veprimtarisë së MABK.

Neni 2
E drejta e lirisë krijuese dhe performuese

Organet Drejtuese të MABK Rilindja, garantojnë të drejtën e lirisë krijuese dhe performuese, për të gjitha format dhe shprehjet artistike në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 3
Historiku i Artit Bashkëkohor

1. Historia e koleksionimit artistik në Kosovë është një praktikë relativisht e re. Shumica e koleksionimit artistik fillon në shekullin XX. Koleksioni ekzistues është në shumicë koleksion i porositur për ndërtesa të ndryshme, institucione shtetërore dhe hapësira të tjera publike.

2. Praktika e koleksionimit privat ka fillet e saj në vitet '90, me hapjen e hapësirave kulturore të pavarura dhe të vetëfinancuara si Galeria Dodona dhe Hani i Dy Robertëve si kundërpërgjigje ndaj shtypjes shtetërore që po ushtrohej nga regjimi serb ndaj komunitetit shqiptar në Kosovë.

3. Shumica e koleksioneve ishin përgjigje ndaj lëvizjeve kulturore të kohës.

4. Kosova zë vend specifik në kontekstin gjeopolitik të Evropës, gjë e cila reflekton në gjuhën kulturore dhe peisazhin e zhvilluar nëpër kohë.

Neni 4
Statusi dhe emërtimi

1. Emri i Muzeut do të jetë: "Muzeu i Artit Bashkëkohor të Kosovës Rilindja" (MABK Rilindja). Muzeu është institucion kombëtar i ndërlidhur me parimet e Kushtetutës dhe Ligjeve të Kosovës.

2. MABK është institucion kombëtar publik, me status të institucionit të shërbimit publik.

3. MABK është institucion kulturor i pavarur nga subjektet politike, fetare, organizmat dhe grupe të tjera të interesit.

Neni 5
Selia, vula dhe logo

1. MABK e ka selinë në Prishtinë.

2. MABK e ka vulën dhe logon e vet.

3. Logo e MABK, zgjedhet përmes konkursit publik.

4. MABK-së i sigurohet shkallë e nevojshme e autonomisë në menaxhimin e buxhetit të planifikuar për këtë institucion në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 6
Misioni

Misioni i MABK është:

1. Muzeu i Artit Bashkëkohor të Kosovës është institucion kombëtar i dedikuar për ekspozimin, koleksionimin, edukimin dhe hulumtimin e artit bashkëkohor, kushtuar qytetarëve të Kosovës, rajonit, Evropës dhe botës.

2. Përveç ekspozimit dhe grumbullimit të veprave të artit bashkëkohor, ai do të inkurajojë dhe lehtësojë diskursin rreth artit dhe shoqërisë me dhe për qytetarët e Kosovës dhe të gjithë individëve të interesuar përmes një programi publik.

3. Si një institucion i hapur MABK do të ekspozojë, grumbullojë dhe mbështesë artin bashkëkohor dhe artistët vendorë dhe rajonit, si dhe ata ndërkombëtarë si një qendër e artit dhe do të promovojë njohuri dhe interes në artin bashkëkohor përmes programeve specifike edukative dhe kërkimore.

Neni 7
Vizioni

Vizioni i MABK është si në vijim:

1. Muzeu i Artit Bashkëkohor të Kosovës do të grumbullojë vepra të artit bashkëkohor dhe do të ndërtojë një koleksion, do ta ruajë atë koleksion për gjeneratat e ardhshme dhe do t'i prezantojë ato në ngjarje të tjera ndërkom-

bëtare të institucioneve të artit bashkëkohor.

2. Muzeu i Artit Bashkëkohor të Kosovës do të jetë një podium dhe qendër për diskursin artistik dhe pjesë e debatit ndërkombëtar mbi artin dhe do të ushtrojë të gjithë veprimtarinë e tij sipas udhëzimeve të parimeve të Kushtetutës dhe Ligjit për Art dhe Kulturë të Republikës së Kosovës.

Neni 8
Veprimtaria

1. Veprimtaria e MABK është me interes publik dhe financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.

2. Veprimtaria e MABK, përfshinë koleksionimin, ekspozimin, konservimin, kurimin e veprave të artit bashkëkohor në Kosovë, rajon, Evropë dhe botë.

3. MABK në ushtrimin e aktivitetit të saj, krijon dhe bashkëpunon në rrafshin e krijimtarisë artistike me institucione homologe, publike, private, vendore dhe ndërkombëtare, si dhe me artistë të pavarur.

4. Krijimi, zhvillimi dhe ruajtja e këtyre marrëdhënieve bëhet duke respektuar legjislacionin në fuqi, dhe me qëllim të realizimit të misionit të MABK, pa cenuar pavarësinë dhe aktivitetin e saj themelor.

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I MABK RILINDJA

Neni 9
Organet Drejtuese dhe Këshilluese

1. Organet drejtuese dhe këshilluese të MABK Rilindja janë:

   1.1. Drejtori/ja i/e pëgjithshëm/me;

   1.2. Këshilli artistik;

   1.3. Departamentet;

   1.4. Administrata;

Neni 10
Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit/es të Pëgjithshëm/me

Drejtori/ja i/e Pëgjithshëm/me raporton direkt te Ministri/ja i/e Kulturës. Drejtori/ja i/e Pëgjithshëm/me përfaqëson Muzeun, është menaxher/e i/e Muzeut dhe kryekurator/e i/e tij. Drejtori/ja është lideri i parë i ekipit dhe do të synojë të ndërtojë një ambient efektiv dhe respektues pune të drejtuar nga përgjegjësitë, detyrat dhe përpjekjet me orientim ekipor për të arritur rezultatet më të mira.

1. Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me i institucionit publik qendror të artit dhe kulturës është organi kryesor ekzekutiv dhe ushtron këto detyra dhe përgjegjësi:

   1.1. Është përfaqësues/e i/e institucionit;

   1.2. Drejtori/ja i/e përgjithshëm/me është në krye të ngritjes dhe organizimit të një administrate që shërben për të gjitha departamentet dhe është përgjegjës për të themeluar një sektor për administratë, financa dhe çështje ligjore për të garantuar transparencë financiare dhe përdorim të drejtë të fondeve.

   1.3. Drejton veprimtarinë artistike, kulturore, administrative dhe or-

ganizative, bazuar ne programin për udhëheqjen e institucionit;

1.4. Administron burimet financiare dhe njerëzore të institucionit;

1.5. Kryen të gjitha detyrat e tjera që i ngarkon ky ligj dhe aktet tjera nënligjore;

1.6. Sipas kërkesës Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me mund të mbështetet nga Këshilli Artistik dhe Këshilli Kombëtar i Arteve, roli i të cilit është të mentorojë themelimin e institucionit dhe mirëqenien e tij. Drejtori/ja e përgjithshëm/me - nëse është e nevojshme me ndihmën e Këshillit Kombëtar të Arteve - do të kërkojë mirëkuptim dhe shkëmbim kolegial me muzetë e tjerë kombëtarë të Kosovës dhe të gjitha institucionet publike dedikuar artit dhe edukimit.

1.7. Organizimi i brendshëm dhe rregullorja e punës

Drejtori/ja i/e Pëgjithshëm/me zhvillon dhe përditëson në mënyrë të pavarur Rregulloren e punës, e cila duhet të ndjekë standardet e llogaridhënies dhe transparencës përbrenda MABK:

a. Rregullorja e punës do të përfshijë një sferë të detyrave për secilin Udhëheqës/e të departamentit dhe të gjitha qëllimet e caktuara për këtë department me përshkrim të punës për secilën pozitë si dhe udhëzimet e komunikimit për përdorim të brendshëm për të siguruar një protokol të drejtë dhe të përgjegjshëm të komunikimit;

b. Rregullorja do të përpilohet dhe zhvillohet nga Drejtori/ja i/e Pëgjithshëm/me në bashkëpunim me të gjithë Udhëheqësit/et e Departamenteve;

c. Secili/a Udhëheqës/e Departamenti duhet të dal me përshkrim të detajuar funksional të punës për pozitat e ndryshme të kërkuara për Departamentin;

d. Secili/a Udhëheqës/e Departamenti duhet të informohet për sugjerimet nga Udhëheqësit/et e tjerë të Departamenteve dhe t'i kërkohet këshilla apo sugjerime për departamentet e tjera dhe Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me do të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për t'i përfshirë këto sugjerime dhe udhëzime;

e. Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me jep udhëzime te cilat bëhen pjesë e integruar e statuteve të MABK-së te cilat duhet të votohen unanimisht nga të gjithë Udhëheqësit/et e Departamenteve dhe Drejtori/ja e përgjithshëm/me;

f. Në rast se nuk mund të gjindet ndonjë vendim unanim për udhëzimet, Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me duhet të informojë Ministrin/en e Kulturës, i cili më pas do të ndërmarrë hapa ndërmjetësues; nëse ndërmjetësimi nuk është i suksesshëm Ministri/ja ka të drejtë të vendosë mbi pjesët kontestuese të përmbajtjes së udhëzimeve;

1.8. Stafi, angazhimi dhe rrjedha e punës

Nëse zhvillimi i MABK-së kërkon rritjen e departamenteve dhe punësime të vazhdueshme Drejtori/e përgjithshëm/me dhe Udhëheqësit/et e Departamenteve do të draftojnë një plan për rritjen e strukturës së organizimit me një spjegim të detajuar për departamentin përkatës si dhe qëllimet dhe stafin e nevojshëm

të tij dhe do të kërkohojnë aprovim te Ministri/ja i/e Kulturës. Të gjitha procedurat e rekrutimit duhet të diskutohen përbrenda dhe konfliktet e interesit duhet të adresohen dhe shmangen;

1.8.1. Në kuadër të MABK-së është edhe organogrami ku në të përfshihen pozitat e rregullta të punës si dhe pozitat me shërbime;

1.8.2. Pozitat e rregullta të punës rekrutohen sipas procedurave të ligjeve në fuqi;

1.8.3. Pozitat me shërbime angazhohen përmes procedurave ligjore në fuqi dhe për angazhimin dhe kohëzgjatjen e tyre vendos menaxhmenti i MABK varësisht nga programi dhe nevojat e paraqitura;

1.8.4. Angazhimi i personave përmes procedurës së shërbimeve nuk nënkupton marrëdhënie të rregullt të punës por angazhim sipas projektit apo programit të aprovuar nga menaxhmenti i MABK-së;

1.8.5. Pas përfundimit të angazhimit, MABK nuk ka detyrime ndaj të angazhuarit;

1.8.6. MABK është i lidhur rreptësisht me Ligjet e Kosovës, veçanërisht lidhur me marrëveshjet e punësimit dhe angazhimeve të lira (*freelancers*);

Neni 11
Zgjedhja e Drejtorit/es të Përgjithshëm/me dhe procedurat e përzgjedhjes

11.1. Komisioni Përzgjedhës:

Ministri/ja i/e Kulturës përzgjedhë Drejtorin/en i/e Përgjithshëm/e të MABK pas një procesi përzgjedhës. Procesi udhëhiqet nga një komision ekspertesh nga fusha i përzgjedhur nga Këshilli Kombëtar i Arteve. Komisioni përzgjedhës përbëhet nga:

a. Dy përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit - të cilët kanë bashkërisht një vote;

b. Një përfaqsues nga Komisioni Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport - me një vote;

c. Dy anëtarë të Këshillit Kombëtar të Arteve, të emëruar nga Këshilli Kombëtar i Arteve - secili/a nga një vote;

d. Dy anëtarë të jashtëm nga skena ndërkombëtare e artit (artistë) - të emëruar unanimisht nga Ministri/ja i/e Kulturës dhe Këshilli Kombëtar i Arteve - secili/a nga një vote;

e. Dy anëtarë të jashtëm nga skena ndërkombëtare e artit (Drejtorë/e të Muzeve/ Institucioneve) - të emëruar unanimisht nga Ministri/ja i/e Kulturës dhe Këshilli Kombëtar i Arteve - secili/a nga një vote.

11.2. Procedura dhe kriteret e përzgjedhjes

a. Komisioni Përzgjedhës do të ftojë individë të kualifikuar vendor dhe ndërkombëtarë përmes një shpalljeje publike duke deklaruar të gjitha kërkesat, kualifikimet dhe kriteret në një përshkrim të detajuar të punës i cili do të publikohet nderkombetarisht;

b. Komisioni Përzgjedhës do të shqyrtojë aplikimet e pranuara dhe do të vendosë se cilin individë të kualifikuar të ftojë për të elaboruar një vi-

sion, planet e ardhme dhe idetë për program në një deklaratë të shkurtë me shkrim (deri në 5000 fjalë). Vendimi rreth secilës ftesë duhet do të merret nga një shumicë e thjeshtë votash të komisionit përzgjedhës. Komisioni përzgjedhës është i lirë të limitojë numrin e të ftuarve me shumicë votash;

c. Komisioni Përzgjedhës do të intervistojë kandidatët e ftuar dhe rrjedhimisht do të vendosë për dy kandidatë me anë të votës unanime. Nëse Komisioni Përzgjedhës nuk mund të arrijë një vendim unanim Ministri/ja i/e Kulturës do të kërkojë të ndërmjetësojë në mënyrë që të gjendet një rezultat. Në rast se nuk mund të gjendet asnjë vendim edhe pas ndërmjetësimit, Komision Përzgjedhës shkarkohet dhe procesi i përzgjedhjes se Komisionit duhet të përsëritet me anetare te rinj;

d. Në rastin kur gjendet një vendim unanim kandidati do të sugjerohet nga Këshilli Kombëtar i Arteve për t'u emëruar nga Ministri/ja i/e Kulturës;

e. Ministri/ja i/e Kulturës do të duhet të emërojë kandidatin e përzgjedhur dhe do të mund të refuzojë apo kundërshtojë atë emërim nëse ka arsye të mirë-bazuara për t'iu frikësuar ndonjë shkeljeje të ligjeve të Kosovës apo në rastin kur rrezikohet siguria kombëtare e Kosovës;

f. Në këtë rast Ministri/ja i/e Kulturës duhet të njoftojë Komisionin Përzgjedhës i cili do te sugjeroje një tjetër kandidat nga përzgjedhja përmes votës unanime;

g. Ministri/ja i/e Kulturës do të informojë kandidatin e përzgjedhur dhe, nëse kandidati pranon emërimin, fillon të negociojë kushtet e emërimit.

Neni 12
Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Artistik

1. Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me emëron një Këshill Artistik me individë vendorë dhe ndërkombëtarë, të respektuar në skenën artistike dhe me përvojë në ngritjen dhe funksionimin e një institucioni bashkëkohor; ky Bord Këshillues nuk ka përgjegjësi ligjore dhe detyrime tjera përveç të mbështesë Drejtorin/en e Përgjithshëm/me dhe Udhëheqësit e Departamenteve si dhe, në rast nevoje, Ministrin/en e Kulturës me këshillat e tij.

2. Anëtarët e Bordit Këshillues duhet të pranohen nga Ministri/ja i/e Kulturës, i/e cili/a do të refuzojë pranueshmërinë bazuar në dyshime të forta në një apo më shumë anëtarë të sugjeruar.

3. Bordi Këshillues mund t'i vendosë vetes direktiva të punës, të cilat ka nevojë të aprovohen nga Drejtori dhe Ministri/ja i/e Kulturës.

4. Bordi Këshillues nuk ka fuqi vendimmarrëse mbi institucionin, programin dhe anëtarët e stafit.

5. Për punën e tij, Këshilli Artistik i përgjigjet Drejtorit/es të Përgjithshëm/me.

6. Këshilli Artistik i MABK është i përbërë nga pesë (5) anëtarë të cilët caktohen në bazë të Rregullores së punës.

Neni 13
Departamentet dhe administrata

1. MABK ka tre departamente kryesore dhe administratën:

1.1. Departamenti për Ekspozita dhe Prodhim;
Departamenti udhëhiqët nga Drejtuesi/ja i/e ekspozitave dhe prodhimit dhe Menaxheri/ja i/e ekspozita dhe prodhimit;

1.2. Departamenti për Konservim dhe Menaxhim të Koleksioneve Departamenti udhëhiqet nga Drejtori/ja e Koleksionit dhe Konservimit, Kuratori/ja i/e Koleksioneve; Departamenti për konservim dhe menaxhim të koleksioneve është po ashtu në krye të të gjitha çështjeve të koleksionit;

1.3. Departamenti për Edukim dhe Hulumtim
Departamenti udhëhiqet nga Drejtori/ja i/e Edukimit, Specialist/e i/e Edukimit dhe Udhëheqësi/ja e Hulumtimit;

1.4. Administrata, Financat dhe Çështjet Ligjore:

a. Administrata, Financat dhe Çështjet Ligjore mbështetë Drejtorin/en dhe Udhëheqësit/et e Departamentit në të gjitha çështjet financiare, ligjore dhe administrative;

b. Administrata, Financat dhe Çështjet Ligjore po ashtu mbikëqyrë rregulloret e ngritura dhe të zbatuara në secilin department sipas Ligjeve të Kosovës;

c. Vetëm Udhëheqësit/et e Departamentit të Administratës, Financave dhe Çështjeve Ligjore mund t'u kërkohet të raportojë direkt te Ministri/ja i/e Kulturës, i cili duhet në këtë rast të njoftojë Drejtorin/en e Përgjithshëm/me për kërkesën e tillë;

2. Emërimi i Udhëheqësve të Departamenteve:

2.1. Udhëheqësit/et e Departamentit emërohen nga Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të Arteve dhe Ministrin/en e Kulturës.

2.2. Ministri/ja i/e Kulturës ka të drejtë vetoje ndaj caktimit të një udhëheqësi/se departamenti mbi baza të rënda të cilat duhet të deklarohen me shkrim. Drejtori/ja, me mbështetjen e Këshillit Kombëtar të Arteve, do të duhet pastaj të sugjerojë një kandidat tjetër.

2.3. Secili departament, përfshirë zyren e Drejtorit/es të Përgjithshëm/me, mund të zgjerohet sipas buxhetit në linjë edhe me miratimin e Ministrit/es të/së Kulturës. Secili zgjerim i stafit permanent dhe krijimi i vendeve permanente të punës duhet të koordinohet dhe të ketë miratimin e Ministrit/es të/së Kulturës sipas elaborimit të përshkrimit të punës dhe sugjerimit të skemave të pagave, sipas ligjeve në fuqi.

Neni 14
Financimi

1. Muzeu i Artit Bashkëkohor të Kosovës pranon financimin nga Qeveria e Kosovës;

2. Financimi do të caktohet me votim të Parlamentit duke siguruar vijueshmërinë e ekzistencës së MABK, duke u pasuar me financimin për Ekspozitat dhe Prodhimin; Edukimin dhe Hulumtimin dhe Konservim dhe Manaxhim të Koleksioneve, dhe pastaj duke u pasuar me financimin për blerjet e veprave për koleksion;

3. Financimi do të sigurohet sipas Ligjeve të Kosovës në llogarinë private të MABK, administruar me përgjegjësi vetanake dhe transparencë nga Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me i/e MABK.

14.1. Elementet e financimit

a. Financimi institucional:
Financimi i infrastrukturës, i cili nuk do te jete i limituar nga shpenzimet e ambienteve të muzeut dhe pagave të të punësuarve dhe shpenzimeve të përgjithshme dhe shpenzimeve rrjedhëse të Muzeut dhe departamenteve të tij - pjesë e financimit institucional mund të jenë edhe shumat e rezervuara për ekspozita;

b. Financimi për Ekspozita dhe Prodhim, Konservim dhe Menaxhim të Koleksioneve, Edukim dhe Hulumtim - financim i të gjitha aktiviteteve të ekspozitave, përfshirë por jo i limituar edhe me hapesiren fizike ekspozuese, tarifat e huazimeve, transportin, sigurimet etj.;

c. Koleksionimi
Financim për blerjet për Koleksion

14.2. Financime të tjera

a. Detyrë e Drejtorit/es të Përgjithshëm/me dhe Udhëheqësve të Departamenteve është alokimi i fondeve për një praktikë të qëndrueshme apo projekt financimi për të siguruar që aktivitetet e muzeut të jenë të pacënuara edhe përtej financimit publik të pranuar.

b. Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me dhe Udhëheqësit e Departamenteve do të komplementojnë financimin publik duke shtuar nga shumat e fituara përmes aplikimeve për projekte financuese vendore e ndërkombëtare, përfshirë alokimin e donacioneve private apo marrëveshjet për sponzorizim me palë të treta.

c. Financimi privat dhe sponzorizimi udhëhiqet nga Ligjet e Kosovës duke ndjekur principet e transparencës përputhshmërisht që të mos ketë asnjë influencë direkte apo indirekte mbi përmbajtjen e ekspozitave, programeve edukative dhe hulumtuese dhe konservimit dhe menaxhimit të koleksionit. Në këtë mënyrë, çdo palë e tretë financuese duhet të përfshihet në një raport i cili do të bëhet publik në faqen e MAB duke cekur emrin dhe subjektin e donacionit, sponzorizimit, mbështetjes, apo ndryshe, nga çdo entitet privat ose shtetëror vendor ose i huaj.

Neni 15
Koleksioni

a. Koleksioni synon të grumbullojë vepra reprezentuese arti të një gjenerate dhe synon që përmes politikës së tij të blerjes të mbështesë skenën aktuale artistike dhe artistët, ndonëse nuk është i limituar të blej vepra të artistëve nga Kosova.

b. Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me së bashku me Drejtor/e i/e koleksionit dhe konservimit do t'i sugjerojë Ministrit/es të/së Kulturës blerjen e veprave. Drejtori/j ai/e Përgjithshëm/me dhe Ministri/ja i/e Kulturës mund të kërkojnë këshilla dhe ekspertizë nga palët e treta dhe Këshilli Kombëtar i Arteve apo nga nje komitet i dedikuar per zhvillimin e koleksionit, në rast nevoje. Secili sugjerim për blerjen do të duhet të shoqërohet me një deklaratë vlerësimi specifik për koleksion si dhe deklaratë të kritereve të konservimit dhe mirëmbajtjes. Ministri/ja i/e

Kulturës nuk do të ndalojë miratimin e blerjes përveç nëse ekzistojnë arsye të rënda ekonomike dhe buxhetore që mund të rrezikojnë të ardhmen e MABK ose nëse ka arsye ligjore që do ta bënte blerjen të paligjshme ose do t'i shkelte ligjet e Kosovës.

c. MABK do të pranojë donacione të veprave përmes vendimit unanim të Drejtorit/es të Përgjithshëm/me dhe Drejtor/e i/e koleksionit dhe konservimit; nëse të dy nuk gjejnë ndonjë vendim unanim Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me do të kërkojë asistencë përmes ndërmjetësimit nga Ministri/ja i/e Kulturës, i/e cili do të ketë mundësinë të vendosë vetë në rast se nuk gjendet ndonjë konsensus.

d. MABK nuk do të pranojë huazime të përhershme të individëve privatë apo entiteteve legale private.

e. MABK nuk do të shesë asnjë vepër nga Koleksioni, vetëm në rast të votës parlamentare të bazuar në ndonjë gjendje emergjente.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky Statut, hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas ditës së nënshkrimit nga...

Nënshkrimi:
Data:

9.
DEPARTAMENTET DHE ORGANOGRAMI

9. Departmentet dhe Organogrami

9.1. Muzeu i Artit Bashkëkohor i Kosovës — MABK Rilindja

Në etapën e hershëm të ndërtimit të institucionit, Muzeu i Artit Bashkëkohor i Kosovës (MABK) do të ketë njëzetë punëtorë në tërësi. Për shkak të numrin të vogël të stafit, fillimisht nuk do të ketë departamente, por mbase një ekip bazë që merr mbështetje nga punëtorët profesionistë me kontrata të përkohshme dhe *freelancers* (të kontraktuar për shërbime). Për të përmbushur misionin dhe qëndrojë i përkushtuar ndaj audiencave dhe komuniteteve të tij, muzeut do të i duhet të inkurajojë bashkëpunime ndërsektorale dhe ndërdiciplinare përbrenda ekipit. Përderisa implementon programet publike dhe zhvillon aktivitete në linjë me misionin, objektivat strategjike dhe planin afatgjatë, punët dhe burimet njerëzore duhet menaxhuar në mënyrë që konstituojnë logjikën e departamenteve (në ardhje). Departamentet dhe organogrami në vijim strukturojnë punën dhe aktivitetet bazë përbrenda këtij institucioni, dhe planifikojnë punësimin e ekipit në tre etapa. MABK pritet të jetë plotësisht operacional në vitin 2027.

Llojllojshmëria e aktiviteteve që mbështetin punën e MABK-së:

- **Aktivitete menaxheriale** (Drejtor/e i/e përgjithshëm, Drejtor/e menaxhues/e, Drejtor/e i/e burimeve njerëzore, Drejtor/e i/e prokurimit, Drejtor/e i/e financave, Menaxher/e operativ/e, Menaxher/e i/e ndërtesës së muzeut, Kordinator/e për shërbime të vizitorëve, Kordinator/e i/e sigurimit të muzeut);

- **Aktivitete kuratoriale** (Drejtor/e i/e përgjithshëm, Drejtor/e i/e ekspozitave dhe prodhimit, Drejtor/e i/e koleksionit dhe konservimit, Kurator/e i/e koleksionit, Kurator/e i/e artit bashkëkohor, Kurator/e i/e botimeve);

- **Aktivitete të edukimit dhe hulumtimit** (Drejtor/e i/e hulumtimit dhe edukimit, Specialist/e i/e edukimit, Udhëheqës/e i/e hulumtimit dhe Kordinatori/e i/e bibliotekës së artit dhe qendrës së edukimit);

- **Aktivitete që lidhen me marrëdhëniet me jashtë** (Strateg/e i/e komunikimit, Krijues/e i/e përmbajtjes, Kordinator/e i/e mediave sociale, Menaxher/e i/e uebfaqës dhe platformave dixhitale, IT dhe zhvillues/e i/e aplikacioneve të muzeut);

9.2. Organet mbikëqyrëse dhe këshillimore të MABK-së

Këshilli Artistik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Këshilli Kombëtar i Artit.

9.3. Administrata dhe departamentet

9.3.1. Sektori i administratës, financave dhe çështjeve ligjore

Sektori i administratës, financave dhe çështjeve ligjore mbështetë Drejtorin/en menaxhues/e dhe Drejtorin/en i/e përgjithshëm/me në përmbushjen e misionin të muzeut, objektivat strategjike dhe planet afatgjata, po ashtu edhe drejtorët e departamenteve tjera, si dhe stafin në tërësi në të gjitha çështjet që përkojnë me financat, ligjin dhe administratën. Sektori i administratës siguron zbatimin e udhëzimeve dhe politikave, rregullave dhe rregulloreve në të gjitha departamentet në përputhje me ligjin e Kosovës. Drejtori/ja menaxhues/e lehtëson procese administrative përbrenda muzeut për të siguaruar rrjedhën dhe zbatueshmërinë në kohë që mbështesin punën e Drejtorit/ës përgjithshme, si dhe siguron vazhdimësinë e punës në muze edhe në periudhat kur muzeu nuk ka Drejtor apo Drejtore të përgjithshme.

Për më tepër, Drejtori/ja menaxhues/e mbikëqyr dy aspekte kryesore: Çështjet ligjore dhe financiare. Drejtori/ja menaxhues/e në bashkëpunim me Drejtorin/en e zyrës për burime njerëzore, Drejtorin/en e prokurimit, Drejtorin/en e auditimit, Drejtorin/en e financave, Drejtorin/en e logjistikës dhe Drejtorin/en e çështjeve ligjore sigurojnë që procesi i prokurimit, pagesat dhe rekrutimi i punonjësve të ri dhe shërbimeve të jashtme të ndodh në kohë dhe përbrenda afateve ligjore. Nji-

kohësisht, sigurohet që gjatë gjithë kohës këto procedura të jenë në përputhje me Ligjin e Kosovës, duke përfshirë Ligjin e Punës dhe Ligjin për Art dhe Kulturë. Drejtori/ja menaxhues/e në bashkëpunim me Menaxherin/en operativ/e siguron që të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet e vizitorëve, sigurinë dhe infrastrukturën fizike dhe dixhitale të muzeut realizohen duke zbatuar standarde të larta dhe ofrojnë shërbime cilësore për audiencat dhe komunitetet e muzeut.

Ekipi i përfshirë: *Shih organogramin, faqe 58→*

9.3.2. Departamentet

Në statutin e MABK Rilindja, përveç sektorit të administratës që luan një rol specifik në mbarëvajtjen e proceseve menaxheriale, muzeu do të ketë edhe këto tre departamente të veçanta:

1. **Departamenti për ekspozita dhe prodhim**
2. **Departamenti për konservim dhe menaxhim të koleksioneve**
3. **Departamenti për edukim dhe hulumtim**

1. Departamenti për ekspozita dhe prodhim

Departamenti për ekspozita dhe prodhim në bashkëpunim me Departamentin për edukim dhe hulumtim është përgjegjës për konceptimin, planifikimin dhe prodhimin e ekspozitave si pjesë e programit publik vjetor. Për të menaxhuar në mënyrë efektive aktivitetet e prodhimit, Drejtuesi/ja i/e ekspozitave dhe prodhimit dhe Menaxheri/ja i/e prodhimit të ekspozitave bashkëpunojnë ngushtë dhe krijojnë marrëdhënie ndërsektoriale brenda përbrenda stafit. Në bashkëpunim të ngushtë me Menaxherin/en i/e operacioneve dhe Menaxherin/en i/e ndërtesës, departamenti ndan përgjegjësinë për hapësirën e punëtorisë të dedikuar për instalimin e ekspozitave dhe përgatitjen e dërgesës në rast të huazimit të veprave të artit që janë pjesë të koleksionit të muzeut. Përveç kësaj, Drejtori/ja i/e departamentit të ekspozitave dhe Kuratori/ja i/e artit bashkëkohor krijojnë marrëdhënie bashkëpunimi dhe komunikim të ngushtë me profesionistë të tjerë të jashtëm për të kuruar programin vjetor publik, ndërsa Menaxheri/ja i/e prodhimit të ekspozitave mban komunikim të vazhdueshëm me dizajnerë të ekspozitave, dizajnerë grafikë dhe profesionistë të tjerë të pavarur të angazhuar për projekte specifike që lidhen me prodhimin e arkitekturës së ekspozitës.

Ekipi i përfshirë: *Shih organogramin, faqe 58→*

1.2. Aktivitetet e departamentit të ekspozitave dhe prodhimit

MABK do të ketë një qasje miqësore ndaj mjedisit në procesin e realizimit të ekspozitave, duke rimenduar numrin e ekspozitave dhe prodhuar një numër të vogël ekspozitash në vit. Ndërkohë, duke eksploruar formate të ndryshme ekspozimi që janë të qëndrueshme dhe ekologjike, duke minimizuar prodhimin duke ripërdorur dhe ricikluar rekuizitat dhe orenditë e ekspozitave.

a. **Program publik**
   Programi publik i MABK-së është një mundësi për muzeun të transformohet në vazhdimësi, të sjellë në dritë artistë, kuratorë, teoricientë të rinjë dhe të afirmuar, dhe të adresojë çështje që lidhen me artin dhe kulturën dhe që kanë rëndësi për shoqërinë në përgjithësi. Drejtorët/et e departamenteve kryesore, Drejtori/ja i/e ekspozitës dhe Drejtori/ja i/e koleksioneve, dhe Drejtori/ja i/e edukimit dhe hulumtimit konceptojnë Programin Publik që përbëhet nga ekspozita të përkohshme, seri ligjeratash, prezantime botimesh, biseda me artistë, programe edukative dhe formate të tjera bashkëpunuese.

b. **Galeritë e ekspozitave të përhershme**
   Duke u nisur nga koleksioni gjithnjë-në-rritje i MABK-së, Kuratori/ja i/e artit bashkëkohor, Kuratori/ja i/e koleksioneve dhe kuratorë tjerë të muzeut, në bashkëpunim me Departamentin e ekspozitave dhe prodhimit konceptojnë narrativën e ekspozitës së përhershme. Termi "i përhershëm" duhet marrë me lehtësi, pasi që me zgjerimin e koleksioneve, Galeritë e ekspozitave të përhershme do të ndryshojnë dhe do të zhvillohen tutje, gjë që krijon hapësirë për ndërhyrje të vazhdueshme dhe rimendim të kornizës konceptuale të galerive të MABK-së.

c. Ekspozitat e përkohshme
Ekspozitat e përkohshme të MABK-së përbëhen nga prezantime grupore dhe individuale artistike. Kjo e fundit është krijuar për të prezantuar punën e artistëve, ndërsa e para ofron një platformë për ekspozita tematike, ekspozita me bazë në hulumtim, retrospektiva dhe bashkëpunime me shoqata dhe kolektive të ndryshme të artit lokal dhe ndërkombëtar. Ky aktivitet është i rregullt në muze, prandaj kërkon një bashkëpunim të ngushtë ndërsektorial midis Kuratorit/ës së artit bashkëkohor, Menaxherit/ës të prodhimit të ekspozitave, Menaxherit/ës së operacioneve dhe Menaxherit/ës të ndërtesës së muzeut.

2. Departamenti për konservim dhe menaxhim të koleksioneve

Departamenti për Ruajtje dhe Menaxhim të Koleksioneve është përgjegjës për të gjitha aspektet e menaxhimit të koleksioneve, nga blerja deri te çregjistrimi, dokumentacioni i regjistrimit, hartimi dhe zbatimi i planeve të fatkeqësive, politikat e menaxhimit, ruajtja e koleksioneve, krijimi i kushteve për koleksione të veçanta, hulumtimi i origjinës, raportet mbi hapësirën ku ruhet koleksioni, huazimi, ekspozitat dhe prezantimi, si dhe mbrojtjen e koleksioneve. Drejtori/ja i/e departamentit për ruajtje dhe menaxhim të koleksioneve së bashku me Kuratorin/ën i/e koleksioneve dhe Menaxherin/en e konservimit planifikojnë zgjerimin, ekspozimin, krijimin e njohurisë mbi (aktivitetet ky që ndërlidhet me Departamentin e edukimit dhe hulumtimit) dhe konservimin e koleksioneve. Për më tepër, së bashku, ata hartojnë politikat e menaxhimit të koleksioneve dhe nëse mungon ekspertiza e brendshme, ata kërkojnë këshilla dhe ekspertizë nga Këshilli Kombëtar i Arteve (sipas Ligjit të ri për Art dhe Kulturën, Këshilli ofron një mbështetje të tillë). Me zgjerimin e koleksioneve, punonjësit përbrenda departamentit duhet të dizajnojnë dhe zhvillojnë një infrastrukturë dixhitale të qëndrueshme për të përditësuar në vazhdimësi informacionin mbi veprat e koleksioneve - këtu Menaxheri/ja i/e uebfaqës dhe platformës dixhitale merr nën udhëheqje këtë proces për të dizajnuar një regjistër efikas dhe me qasje të hapur që të ofrojë një përvojë miqësore për përdoruesit e kësaj platforme.

Ekipi i përfshirë: *Shih organogramin, faqe 58→*

a. Politikat e menaxhimit të koleksioneve
Një dokument që percakton politikat e menaxhimit të koleksioneve të MABK, ndryshe është një deklaratë e shkruar gjithëpërfshirëse që përcakton qëllimet e muzeut dhe shpjegon se si këto synime ndiqen përmes aktivitetit të koleksionimit. Politika menaxhuese artikulon standardet profesionale të muzeut në lidhje me veprat e lëna në kujdesin e tij dhe shërben si një udhëzues për ekipin e muzeut, dhe si një burim informacioni për publikun. Një politikë e tillë përveç që rregullon aktivitetet e përditshme brenda koleksioneve të një muzeu, po ashtu standardizon procedurat e aktivitetit të koleksionimit.

Para se të draftohen politikat menaxhuese të koleksionit, kërkohet konsultimi i pikave si në vijim:

- Nevoja për të sqaruar statusin e muzeut (A është një organizatë jofitimprurëse? A është një institucion i varur nga Ministria? A është pjesë e një organizate më të madhe arsimore, si p.sh. një njësi brenda një kolegji apo universiteti?);
- Nevoja për të identifikuar dhe mbledhur të gjitha dokumentet që përcaktojnë qëllimin e muzeut (misioni i muzeut dhe statuti) dhe që mund të vendosin kufizime ose kushte në funksionimin e muzeut;
- Nevoja për të qartësuar linjat e autoritetit dhe për të identifikuar se kush, në fund të fundit, ka fuqinë për të miratuar politikën për muzeun në fjalë;
- Nevoja për t'u njohur me autoritetet e jashtme që kryejnë ose mund të kenë mbikëqyrje të aktiviteteve të caktuara muzeale;

Duhet siguruar që politika e menaxhimit të koleksionit të përfshijë:

- Qëllimi i muzeut dhe qëllimet e koleksionit;
- Mënyra e blerjes së veprave për koleksione;
- Mënyra e asgjësimit të veprave nga koleksioni;
- Politikat e hua-marrjes dhe dhënies;

- Trajtimi i veprave të lëna në ruajtje të muzeut;
- Kujdesi dhe kontrolli i veprave të koleksionit në përgjithësi;
- Qasja në veprat e koleksionit;
- Masat dhe procedurat për të siguruar veprat e koleksionit;
- Regjistrimi i të dhënave që duhet bërë si pjesë e aktivitetit të koleksionimit; kur duhet të bëhen këto regjistrime dhe ku duhet të mbahen;

b. Politikat që klasifikojnë veprat e koleksionit

Kjo politikë duhet të detajoj aktivitetin e koleksionimit përbrenda kontekstit të MABK-së dhe të nxjerr në pah llojin e medias së veprave individuale artistike dhe kriteret që rregullojnë blerjen dhe huamarrjen. Politikat nuk krijohen vetëm për të pasqyruar koleksionin ekzistues, por synojnë të jenë më vizionare dhe të tregojë gjerësisht mënyrën në të cilën parashikohet të zgjerohet dhe zhvillohet koleksioni në të ardhmen. Si një dokument institucional që rregullon punën në muze, kjo politikë rishikohet çdo tre vjet dhe kërkon miratim formal nga Këshilli Artistik (apo cilido organ mbikëqyrës), ndërsa ndryshimet më urgjente mund të paraqiten për miratim gjatë gjithë kohës. Rishikimi i vazhdueshëm i politikave mund të mendohet si një mjet për të lehtësuar ndryshimet përbrenda kontekstit institucional, duke lejuar që aktiviteti koleksionues i muzeut të pasqyrojë më së miri misionin gjithnjë-në-zhvillim të muzeut.

Shënim: Pavarësisht çdo përpjekjeje që mund të bëjë MABK për të artikuluar qartë dhe definuar mirëfilli aspekte të ndryshme të koleksionit të tij, gjithmonë do të ekzistojnë vepra arti ose objekte të kulturës materiale që lidhen me artistin/en që nuk arrijnë të gjejnë një vend adekuat përbrenda strukturës së koleksionit të muzeut. Materialet përcjellëse të veprave të artit shpesh mjegullojnë kufijtë midis këtyre dallimeve dhe e detyrojnë institucionin të vë në pyetje strukturat e tij të brendshme, natyrën e koleksioneve të tij dhe mënyrën në të cilën muzeu ka koleksionuar në të kaluarën, koleksionon aktualisht dhe do të koleksionojë në të ardhmen.

c. Definicione që lidhen me aktivitetin e koleksionimit

- "Vepër koleksioni" është një objekt material që ka qenë ose është në proces të bërjes pjesë të koleksionit të muzeut.
- "Përvetësimi" ose "blerja" është procesi formal që përdoret për të pranuar dhe regjistruar një objekt si vepër koleksioni.
- "Asgjësimi" është procesi formal që përdoret për të hequr një objekt nga koleksioni përgjithmonë ose, kur një objekt është humbur ose shkatërruar, procesi formal që përdoret për të dokumentuar humbjen në regjistrat e koleksionit.
- "Huazimi" është marrje apo dhënie në kujdes të përkohshëm të veprave të artit. Muzeu mund të huazojë vepra apo të i jap në huazim veprat e tij nga koleksioni. Kjo bëhet për qëllime të deklaruara muzeale, të tilla siç janë ekspozimi dhe hulumtimi. Këto aktivitete nuk nënkuptojnë ndryshim të pronësisë së objektit muzeal.
- "Objektet e vendosura në kujdes të muzeut" mund të jenë vepra, dokumentacion, apo materiale të artistëve që nuk janë në pronësi të muzeut, por janë lënë përkohësisht në muze për qëllime të tjera përveç huadhënies, si për atribuim, identifikim ose ekzaminim për dhuratë ose blerje të mundshme.

ç. Sistemi i menaxhimit të koleksioneve

Regjistrimet e futura në sistemin e menaxhimit mund të përfshijnë detaje të tilla si dimensionet, çmimi i blerjes, një përshkrim i secilit objekti dhe çmimi i sigurimit të tij. Për vendndodhjet, mund të ekzistojë një sistem për t'u siguruar që vendndodhja e çdo objekti që është regjistruar në një regjistër qendror, dhe se sa herë që një objekt zhvendoset, qoftë objekt në lëvizje të përhershme apo të përkohshme (huadhënie), data e lëvizjes dhe vendndodhja e re duhet regjistruar. Në këtë mënyrë, historia e një objekti mund të ndërtohet dhe të shtohet me çdo huazim dhe ekspozim në lokacione tjera jashtë muzeut.

Sistemi duhet të përmban informacion mbi:

- Çfarë është në koleksion - çfarë është blerë; marrë si dhuratë, dhurim ose trashëgimi; ose të fituara në ndonjë mënyrë tjetër;
- Ku janë objektet tani – vendndodhjet e tyre aktuale; ose një procesverbal nëse ato janë larguar nga koleksioni përmes shitjes, dhurimit, transferimit, humbjes ose asgjësimit;

Rreth kritereve dhe rrgullave tjera për zhvillimin e koleksioneve të MABK, shih kapitullin në vijim, specifikisht pikën 10.2., faqe 63→

3. Departamenti për edukim dhe hulumtim

Duke u bazuar në koleksionet, arkivat dhe programin e ekspozitave të përkohshme dhe përhershme, Drejtori/ja i/e edukimit dhe hulumtimit në bashkëpunim me Specialistin/ën i/e edukimit dhe Udhëheqësin/en i/e hulumtimit është përgjegjës për hartimin e programeve që angazhojnë grupe dhe komunitete të ndryshme në aktivitete mësimore dhe kërkimore. Departamenti për edukim dhe hulumtim u ofron mundësi audiencave të ndryshme për të punuar me një gamë të gjerë veprash artistike nga koleksionet dhe angazhohet në krijimin e një qasje të hapur në koleksione dhe arkiva për të mbështetur arsimin formal dhe për të inkurajuar arsimin informal për të gjitha grup-moshat. Hulumtimi në veçanti si një aktivitet muzeal është i lidhur me koleksionin dhe arkivin e muzeut, dhe si i tillë zhvillon dhe adopton optika të ndryshme teorike bashkëkohore për të interpretuar koleksionet dhe ekspozitat, dhe me angazhimin e hulumtuesve dhe studjuesve të rinjë në programe të ndryshme kërkimore të muzeut sigurohet që në vazhdimësi të prodhohet njohuri lokale mbi artet pamore që komunikojnë përmbajtësisht në nivel global. Nëpërmjet formave të reja dhe bashkëpunuese të krijimit të dijes, Kuratori/ja i/e botimeve, do të kurojë dhe redaktojë publikime të cilat do të bazohen në koleksionet dhe arkivat e muzeut dhe më gjërë, që do të krijojnë një burim të rëndësishëm informacioni për audienca të ndryshme të interesuara në kulturën pamore lokale. Departamenti për edukim dhe hulumtim përgjithësisht kontibuon në rritjen e vlerës së objekteve muzeale përmes edukimit të publikut dhe hulumtimit të trashëgimisë dhe kulturës pamore lokale.

Ekipi i përfshirë: *Shih organogramin, faqe 58→*

3.1. Aktivitetet edukative

- Ngjarje dhe aktivitete edukative (Punëtori me artistë, kuratorë, guida në muze, guida për familje);
- Edukimi për fëmijë;
- Edukimi i dizajnuar për shkollat e mesme;
- Vizita të pavarura në grup për mësuesit (mbështet inovacionin në edukimin artistik)
- Vizitë në grupe të pavarura (për të rritur)
- Edukimi për stafin e muzeut;
- Edukimi i dizajnuar për t'u plasuar në platformat online;

a. Aktivitetet brenda muzeut

Muzetë kanë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve arsimore për audiencën e tyre, qofshin këta fëmijë apo të rritur. Muzeu duhet të ofrojë një sërë mundësish mësimore formale, gjithashtu të punojë ngushtë me mësuesit/et për t'i lejuar mësuesit/et të përdorin më mirë burimet arsimore të disponueshme përmes prezantimeve dhe ekspozitave, databazave, dhe koleksioneve.

Një Specialist/e i/e edukimit muzeor mund të ketë një vlerë të madhe për një muze. Ai ose ajo mund të jetë i vetmi anëtar i ekipit me trajnim në psikologjinë e të mësuarit dhe mund të ketë përvojë të konsiderueshme në analizimin e koncepteve komplekse dhe paraqitjen e tyre në një mënyrë të thjeshtë para një audience jo të specializuar apo të fushës së artit. Specialisti/ja i/e edukimit mund të jetë, në të vërtetë, ndër ata profesionistë të rrallë që do të jenë komunikues ose përkthyes të përmbajtjes për të gjitha grup-moshat në muze.

Programe për edukatorë: Muzeu duhet të përpiqet të organizojë – ndoshta një herë në vit – trajnim një-ditor për mësuesit. Idealisht, kjo do të rregullohej përmes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ose Ministrisë së Arsimit, dhe mësuesve do t'u lihej kohë për të marrë pjesë në aktivitete të muzeut. Ato aktivtetet mbahen në kontekst të muzeut dhe drejtohen nga një specialist/e i/e edukimit muzeor. Megjithatë, aty duhet të përfshihet i gjithë ekipi i muzeut, sepse njohja e personelit dhe edukatorëve të muzeut do të jetë një përfitim i madh në të ardhmen.

Publikimi i materialeve arsimore për fëmijë: Muzetë duhet të ndihmojnë mësuesit të përdorin muzetë duke ofruar materiale arsimore. Se çfarë duhet të jenë këto do të varet shumë nga misioni i muzeut dhe nevojat e shkollave lokale. Për të tërhequr vizita nga më shumë se një ose dy shkolla, muzeu në bashkëpunim me Hulumtuesit/et dhe Kuratorët/et e botimeve duhet të publikojë botime të ndryshme me shkallë të ndryshme kompleksiteti që kanë të bëjnë me artin lokal dhe ndërkombëtar për të siguruar edukim në arte pamore për grup-mosha të ndryshme.

Përveç kësaj, për ta bërë muzeun lehtësisht të qasshëm, aktivitetet e edukimit dhe hulumtimit duhet të gërshetohen dhe resurset njerëzore duhet të bashkëpunojnë ngushtë rreth aktiviteteve botuese dhe botojnë libërtha që përshkruajnë në detaje atë që muzeu mund t'u ofrojë shkollave për të plotësuar kurrikulën e tyre. I njëjti informacion duhet të jetë në uebfaqën e MABK-së.

Libërthat duhet të përfshijnë:

— Një përshkrim të vitrinave me informacion (nëse ka);
— Emri i specialistit/ës të edukimit të muzeut;
— Si të rezervoni kohën për një vizitë me gjithë klasën;
— Cilat shërbime janë në dispozicion, p.sh. bashkëbisedime, vizita me guidë, ngjarje;
— Lehtësitë që ofrohen dhe janë në dispozicion të grupeve;
— Salla e edukimit;
— Materiale audio-vizuale, modele;
— Dyqani i muzeut;
— Hapësira për gosti;
— Toalete;
— Tabelat, lapsat, etj.
— Informacion rreth qasjes: a është i përshtatshëm për fëmijët me aftësi të ndryshme?

b. Aktivitetet jashtë muzeut

Muzeu nuk duhet të vetëkënaqet duke pritur që njerëzit të vijnë dhe t'i vizitojnë, por duhet t'i aktivisht t'i ofrojë shërbimet e tij në komunitet. Shërbimet e edukimit në muze nuk duhet të u ofrohen vetëm fëmijëve nga shkollat që vizitojnë – muzeu duhet të ndërmarrë aktivitete të ndryshme që nxjerrin atë jashtë mureve të tij dhe të krijoj prani në pjesë të tjera të komunitetit që nuk kanë qasje të lehtë në MABK.

Bisedat në shkolla

Fëmijët gjithmonë vlerësojnë të tjerët që flasin me ta përveç mësuesit/et të tyre. Punëtoritë, bashkëbisedimet dhe formatet tjera interaktive rreth historisë së artit ose aktiviteteve të lidhura me historinë e artit në kontekstin e shkollës e sjellin muzeun më afër audiencës së tij më të re. Andaj, ato duhet të organizohen në vazhdimësi për të kultivuar publikun e moshave të reja.

Klubet e fëmijëve dhe aktivitetet gjatë festave

Klubet e fëmijëve zakonisht takohen në fundjavë ose pas shkollës dhe ato janë të kufizuara me anëtarë, megjithëse çdo fëmijë mund të bashkohet nëse ka një vend. Një muze pa një specialist/e të edukimit ka shumë gjasë të tërheqë vëmendjen e një ose më shumë mësuesve lokal për të ndërmarrë aktivitete fes-

tash, ndërsa një klub për fëmijët më të rritur mund të drejtohet nga një kurator/e dhe mund të bëjë punë vërtetë dobishme për muzeun.

Ngjarje të veçanta
Një nga mënyrat më efektive për të ofruar mundësi edukimi në muze është organizimi i ngjarjeve të veçanta. Këto mund të zgjasin gjysmë dite, një fundjavë ose dy javë. Këto aktivitete mund të marrin trajta të ndryshme. Një qasje e zakonshme është zgjedhja e një teme – e cila mund të jetë një aktivitet si 'teknikat artistike', ose një klasë objekti si 'rrotat' ose një periudhë specifike historike. Nëse synohet për shkolla, ai duhet të lidhet me detyrat shkollore që bëjnë fëmijët që marrin pjesë.

3.2. Aktiviteti hulumtues
Drejtori/ja i/e departamentit të edukimit dhe hulumtimit, së bashku me hulumtues, kuratorë dhe specialistë të edukimit, jo vetëm që do të realizojnë hulumtime, por edhe do të përcaktojnë numrin e katalogëve të ekspozitave, publikimeve, libërthave informativ arsimor që do të botohen në vit. Së bashku me veprimtarinë kërkimore dhe botuese, për të siguruar përfshirje shoqërore të komuniteteve të ndryshme, ky departament do të hapë çdo vit thirrje dhe mundësojë bursa, duke ftuar hulumtues lokalë dhe ndërkombëtarë të kontribuojnë në aktivitetet hulumtuese dhe mësimore të MABK-së.

a. **Botimet (të shtypura dhe online) —** MABK angazhohet rregullisht në aktivitetin e botimit. Udhëheqësi/ja i/e hulumtimit dhe kuratori/ja i/e botimeve janë përgjegjës për konceptimin dhe organizimin e punës rreth botimit të katalogëve të ekspozitave, katalogëve të koleksioneve, udhëzuesve për koleksionin dhe serive të botimeve të kuruara (dhe formate të tjera sipas nevojës). Katalogët e ekspozitave dhe koleksioneve inkurajojnë mënyra të reja të angazhimit dhe reflektimit përballë programeve të ekspozitave dhe artistëve të koleksionit. Përveç kësaj, seria e botimeve të kuruara është një mundësi për të zbuluar tema dhe për të krijuar lidhje që përndryshe nuk janë menjëherë të dukshme përmes ekspozitave, koleksioneve dhe programeve publike. Aktivitetet e botimit e bëjnë të dukshme llojllojshmërinë e muzeut dhe ofrojnë për publikun e gjerë një mënyrë tjetër për t'u angazhuar me artin, kulturën dhe historinë lokale.

b. **Programi i bursës kërkimore —** MABK ofron një mjedis që përkrahë dhe mbështetë studiuesit që të inicojnë hulumtime që lidhen me koleksionin, konservimin dhe praktikat muzeale të muzeut, dhe zhvillojnë praktika të reja të mësim-nxënies në kontekst të muzeut. Programi i bursave është gjithashtu një mundësi për të sjellë bursistë nga e gjithë bota për të gjeneruar perspektiva të reja mbi artin lokal dhe për të avancuar praktikat kërkimore ndërdisiplinore dhe për të inicuar projekte të reja botuese.

c. **Programi i praktikës për diversitet —** MABK zhvillon mënyra për të inkurajuar komunitetet minoritare gjithandej Kosovës që të ndjekin profesione në fushën e muzeologjisë dhe të zgjerojnë historitë e kulturës pamore të lidhura me komunitetet e tyre brenda kontekstit të muzeut, gjatë gjithë kohës që këta praktikantë marrin mbështetje, trajnim dhe ekspertizë. Programi i praktikës është një mundësi për muzeun që të kontribuojë në njohjen ndërkulturore, dialogun historik, dhe angazhimin në komunitet.

ç. **Programi i angazhimit të studentëve —** MABK u ofron studentëve të universitetit, të sapodiplomuarve dhe studentëve të diplomuar një gamë të gjerë përvojash përmes programit të angazhimit pa pagesë, i cili është dizajnuar enkas për të dhënë një pasqyrë të funksionimit të një mjedisi muzeor. Përveç punës në projekte me stafin e muzeut, praktikantët ndjekin një sërë trajnimesh dhe seminaresh rreth muzeologjisë bashkëkohore.

3.3. Infrastruktura e kujtesës së muzeut

a. **Platforma dixhitale e muzeut** duhet të konceptohet si një mjet kërkimor që do të integrojë në një platformë të vetme veprat e MABK-së, pavarësisht nga lloji i tyre, qofshin të karakterit artistik, dokumentar, fotografik, jomaterial. Platforma dixhitale duhet të kurohet si një hapësirë online që tejkalon organizimin tradicional të objekteve muzeale dhe gjeneron hapësira që mundësojnë ndërtimin e marrëdhënieve të ndryshme midis burimeve të arkivit dhe koleksionit të MABK-së. Ky aspekt relacional, në të cilin materialet nga burime të ndryshme konvergjojnë, lejon që ekspozitat dhe veprat e ekspozuara të ndërlidhen me arkivet përkatëse, materiale të tjera referuese, fotografi të ekspozitave dhe materiale tjera të artistëve të ekspozuar — të cilët nga ana tjetër mund të ndërlidhen me veprat dhe ekspozitat që janë prodhuar në të kaluarën. Kjo praktikisht lejon unifikimin e materialeve të ruajtura në departamente të ndryshme, dhe shënon një kontribut të mëtejshëm në ndërtimin, ruajtjen dhe diseminimin e kujtesës së muzeut.

b. **MuseumPlus** është një opsion (ndër shumë të tjerë) për muzeun për të inventarizuar veprat e artit, për të menaxhuar huazimet e veprave dhe lëvizjet e ekspozitave të përkohshme, për të regjistruar ndërhyrje restauruese dhe në përgjithësi, për të integruar të gjithë punën që lidhet me trashëgiminë e këtij institucioni. Linku: www.zetcom.com/en/museumplus-en/

c. **Uebfaqja** ofron përshkrime që bazohen në historinë e aktiviteteve dhe ekspozitave të tanishme dhe të kaluara të MABK-së.

ç. **Arkivi qendror i MABK-së** është përgjegjës për tërë dokumentacionin e prodhuar nga institucioni; këtu ruhet kryesisht dokumentacioni administrativ dhe menaxherial, i cili me kalimin e kohës merr vlera të ndryshme, por këtu gjithashtu ruhen edhe koleksione të tjera me vlerë historike dhe kërkimore. Arkivat administrative duhet të përballen me një analizë të kujdesshme funksionale që përcakton qartë: çfarë dokumentacioni gjenerojnë, *ku* ruhen, *kush* është përgjegjës për të, *si* i përcaktojnë tipologjitë e tyre dokumentare dhe si emërtohen dosjet fizike ose dixhitale për ruajtje sipas një standardi apo kriteri të përbashkët. Si nëpunës publikë, profesionistët e muzeut janë kujdestarë dhe përgjegjës për atë që prodhohet brenda kontekstit të muzeut, ata pas vetës do të lëjnë një dëshmi autentike dhe të besueshme për të qenë në gjendje të rindërtojnë historinë e muzeut në të ardhmen.

Checklist-a e Arkivit qendror: Përveç informacionit të ruajtur në sistemin e menaxhimit të koleksionit, checklist-a përfshin: Agjendat dhe procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Artistik; agjendat dhe procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve; dokumente të prodhuara nga Këshilli Artistik; dokumente politikash; llogaritë dhe të dhënat tjera financiare; planet menaxhuese afatgjate; raportet vjetore; njoftime për shtyp; kopje të artikujve rreth muzeut në gazeta të përdishme (online dhe të shtypura); kopjet e botimeve të muzeut; recenzione mbi veprimtarinë e muzeut; CV-të e anëtarëve të Këshillit Artistik; CV-të e stafit të muzeut dhe vullnetarëve; letra për dhe nga muzeu; fotografi; imazhe në lëvizje (video); transkriptet e transmetimeve televizive dhe radiofonike; transkriptet e ligjeratave; botime muzeale të të gjitha llojeve; biblioteka e muzeut dhe/ose botime të tjera (për kërkime).



Punësimet e etapës së parë Punësimet e etapës së dytë Punësimet e etapës së tretë


Organet mbikëqyrëse dhe këshillimore
Këshilli Artistik
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Këshilli Kombëtar i Arteve
Departamenti për konservim dhe menaxhim të koleksioneve
Departamenti për edukim dhe hulumtim
Drejtor/e i/e koleksionit dhe konservimit
Drejtor/e i/e edukimit dhe hulumtimit
Kurator/e i/e koleksioneve
Asistent/e kuratorial/e për hulumtimin e koleksionit
Menaxher/e i/e konservimit të koleksionit
Zyrtar/e i/e regjistrave të koleksioneve
Specialist/e i/e edukimit
Udhëheqës/e i/e hulumtimit
Asistent/e i/e edukimit
Asistent/e i/e hulumtimit
Kurator/e për zhvillimin e publikut dhe komuniteteve
Kordinator/e i/e ndërmjetësimit
Kurator/e i/e botimeve
Kurator/e i/e platformës online të muzeut
Kordinator/e i/e bibliotekës së artit dhe qendrës së edukimit
Studiues bursistë
Studentë praktikantë/ asistentë të përkohshëm
Studiues të rinjë
Praktikantë të programit të diversitetit
Freelancers (të kontraktuar për shërbime)
Dizajner/e grafik/e
Dizajner/e i/e ekspozitave
Kuratorë të jashtëm, teoriticientë dhe hisorianë të artit

10.
KOLEKSIONI I MABK RILINDJA

10. Koleksioni i MABK Rilindja

10.1. Historiku i koleksionimit në Kosovë

Koleksionimi i artit është një praktikë relativisht e re ne Kosovë. Me një kontekst specifik gjeopolitik përbrenda Evropës, Kosova ishte pjesë e Perandorisë Osmane dhe pjesë e mbretërive të tjera jugosllave, dhe pas Luftës së Dytë Botërore Krahinë Autonome në Jugosllavinë Socialiste. Me shpalljen e pavarësisë së saj në vitin 2008, është vend me një demokraci në konsolidim e sipër. Të gjitha këto specifika janë tregues të kontekstit të saj në raport me diskurset dhe gjuhën artistike ndërkombëtare, i cili kontekst dhe te cilat specifika duhet ta informojnë programin dhe politikat e MABK-së.

Historia e re e koleksionimit të artit në Kosovë fillon në mesin e shekullit XX, kur federata ish-Jugosllave komisiononte vepra arti nga artistë prominent të vendit, për ti ekspozuar ato në ndërtesa të rëndësishme shtetërore, siç janë: Hotel Grand, Pallati i Rinisë dhe Sporteve dhe objekte të tjera administrative, edukative, e shoqërore (koleksioni i Hotel Grand është sot pjesë e koleksionit të Galerisë Kombëtare të Kosovës). Ndërsa, praktika e koleksionimit privat, për aq sa dijmë, ka fillar rreth viteve '90, duke filluar njëkohësisht me hapjen e hapësirave alternative të kulturës, siç janë: Galeria Dodona, kafe galeria Hani i Dy Robertëve, e të tjerë, hapësira këto të krijuara si kundërpërgjigje ndaj represionit shtetëror të ish-Jugosllavisë që shqiptarët e Kosovës përjetuan nga viti 1991. Gjatë kësaj kohe, kolelsionimi në përgjithësi ishte bërë me inercion dhe jo si rezultat i politikave kohezive për koleksionim.

Sot, Kosova ka disa koleksione publike të artit, të cilat dallojnë për nga kushtet e mirëmbajtjes, ruajtjes, konservimit. Koleksioni më prominent është ai i Galerisë Kombëtare të Kosovës. Tutje, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka përvetësuar një koleksion gjatë pandemisë COVID-19 si ndihmesë financiare për artistët e vendit. Më pas, MKRS poashtu ka blerë vepra të artit të ekspozuara në bienalen nomade, Manifesta, e cila mbajti edicionin e saj te 14të në Prishtinë. Tutje, disa prej koleksioneve ekzistuese kanë karakter privat dhe disa janë të korporatave të ndryshme private. Kur MABK zhvillon politikat e saja për koleksionim dhe për koleksionin e saj, është e udhëzuar që të ketë parasysh statusin, gjendjen dhe natyrën e koleksioneve ekzistuese në vend.

Urgjenca për të koleksionuar — Simpoziumi i mbajtur në tetor të vitit 2022, i organizuar nga Këshilli Inicues i MABK, i cili kishte për qëllim diskutimin mbi modelet institucionale dhe praktikat e koleksionimit, ka dhënë detaje dhe dije të cilat më pas informuan këtë dokument. Panelistët pjesëmarrës ofrouan njohurinë dhe përvojën e tyre profesionale përbrenda konteksteve të tyre institucionale. Ana Janevski, kuratore e Muzeut të Artit Modern, Nju Jork, përgjëroi palët potenciale të interesit që ta njohin urgjencën për të krijuar një koleksion sa më parë, që ta njohin momentin e rëndësishëm kohor, para se veprat e artit bashkëkohor të koleksionohen nga koleksionues privat, dhe të mos gjinden më në Kosovë fare. Catherine Nichols, mediatore kreative e Manifesta 14, tha se praktikat muzeale dhe institucionale të establishuara janë të sfiduara, sepse shpesh ato perfaqësojnë 'tiraninë e shumicës,' duke i anashkaluar grupet e margjinalizuara të shoqërisë. Duke e marrë parasysh këtë, Nichols propozoi që udhëheqësit e koleksionit të MABK të krijojnë hapësirë për artistët të cilët historikisht i kanë takuar komuniteteve dhe grupeve të margjinalizuara dhe janë shtyer në periferi. Vesa Sahatçiu, historiane e artit, inkurajoi që të hulumtohet regjioni dhe përtej, për shembuj të ngjashëm me atë të Kosovës, si për shembull shtetet Baltike, të cilat ballafaqohen me sfida të ngjashme në art. Ajo poashtu theksoi se vetëm kopjimi i modeleve të huaja për të intepretuar praktikat e artit në Kosovë, është formë e pamjaftueshme e punës, meqë kësisoj presupozon mungesë të agjencisë/subjektivitetit nga ana e artistëve të vendit, të cilët kanë demonstruar aftësi për të prodhuar vepra të jashtëzakonshme, të cilat reflektojnë mbi sfidat e lokalitetit të tyre.

Koleksionimi si formësim i rrëfimeve — Koleksioni i MABK është një mundësi që jo vetëm të ndërohet identiteti kombëtar i Kosovës, por edhe që të inicohen bashkëbisedime mbi këtë nocion; të ri-mendohen dhe të ri-imagjinohen pra, narrativat ekzistuese dhe e establishuara identitare. Duke koleksionuar, MABK do të sodisë këtë koncept të çështjes së identitetit kombëtar, dhe ajo kësisoj duhet që ta ketë parasysh se narrativat identitare janë nocione dhe koncepte të hapura dhe dinamike, e jo pozicione dhe 'të vërteta' të panegociueshme. koleksioni i MABK-së duhet ta reflektojë këtë qasje të hapur dhe demokratike. Kjo qasje është posaçërisht e pështatshme nëse MABK vendoset te objekti ish-shtypshkronja Rilindja, i cili objekt në vete ngërthen një trashëgimi të pasur kulturore, me ç'rast MABK do ta ketë obligimin që ta menaxhojë hapësiren dhe ta bëjë rrëfimin e saj të qasshëm për publikun.

Koleksionimi si forcim i raporteve në mes të artit dhe audiencës — Artistët flasin me dhe nëpërmjet punës së tyre. Koleksionet mbajnë gjallë këto 'biseda', duke nxitur kështu biseda dhe shkëmbime të tjera, të cilat pastaj hapin mundësi të reja krijuese dhe interpretuese. Kësisoj, koleksionimi shtetëror legjitimon kulturën e gjërë, duke vënë në pah po ashtu, subjektivitetin dhe vullnetin e artistëve kosovar.

Koleksionimi si proces i përbashkët — Koleksioni duhet që të krijohet në bazë të kontributit të grupeve të ndryshme të interesit, *jo* në saje të interesave të një individi, apo të një grupi. Koleksionimi duhet të jetë një ndërmarrësi e përbashkët, një proces transparent, i bazuar në sistem të kontrollit dhe bilancit. Blerjet dhe përvetësimet duhet që të vendosen nga një komision i përbërë nga profesionistë të fushave të ndryshme, të cilët angazhohen me rotacion.

Koleksionimi si frymëzim për programe publike — Koleksioni frymëzon programin publik të muzeut, pasiqë punët e koleksionit mund të shfrytëzohen për organizimin e ngjarjeve të ndryshme. Kësisoj, koleksioni është një mjet i cili bën që muzeu të funksionojë me tërë potencialin e vet. Sa më shumë punë që përvetësohen për koleksion, aq më shumë rriten mundësitë për të realizuar programe inovative, ndërdiciplinare dhe eksperimentale.

Koleksionimi si avancim i diversitetit, barazisë dhe gjithpërfshirjes — Historikisht dhe duke përfshirë të gjitha kulturat, gratë, komuniteti LGBTQIA+ dhe minoritetet e tjera shoqërore, kanë qenë pamjaftueshëm të përfaqësuar në art, shoqëri dhe politikë. Mungesën e përfaqësimit të këtyre grupeve në koleksione, arkiva dhe institucione tjera kulturore e gjejmë edhe në Kosovë. Por, përderisa shoqëritë perëndimore aktivisht janë ballafaquar me këtë çështje dhe e kanë sfiduar këtë diskriminim, Kosova ka çaluar në njohjen e këtij problemi dhe të kësaj çështje aq emergjente, e cila afekton edhe vet substancën e një institucioni demokratik.

Marrë parasysh këtë, dhe për ta përshkruar më saktë me anë të numrave boshllëkun në perfaqësimin e artisteve gra, duhet shiquar jo më larg se te numrat në koleksionet ekzistuese publike. Koleksioni i GKK-së konsiston prej vetëm 4% të artisteve gra të perfaqësuara në te. Ndërsa, 16% e artisteve gra përbëjnë koleksionin e periudhës së COVID-19. Marrë parasysh këtë, është imperative që MABK të krijojë mekanizma të cilat andresojnë këtë boshllëk në perfaqësimin e grave artiste në institucionet publike të artit. Qasja e njëjtë duhet të aplikohet për minoritetet e tjera të nënpërfaqësuara – siç janë minoritetet etnike dhe ato joetnike – me theks të veçant te komuniteti LGBTQIA+.

Duke reflektuar mbi atë qe u tha më lartë, është e kjartë se nëse një koleksion përvetësohet ashtu siç duhët, vlera e saj shkon përtej përbërjes faktike të veprave në të. Kjo posaçërisht nëse artistët lokal koleksionohen bashkarisht dhe njëkohësisht me artistët e disaporës dhe ata të nacionaliteteve të tjera. Me kohë, kur vepra të reja përvetësohën, fushëveprimi dhe konturat e koleksionit rinegociohen. Kësisoj edhe ngjizen mundësi të reja për tu krijuar raporte në mes të Kosovës dhe botës, duke asgjësuar kështu stereotipet reduktive të *Tjetrit*. Është me rëndësi të theksohët se artistët kosovarë janë shkolluar në akademi të ndryshme

botërore. Kjo edhe ka informuar stilin eklektik (të gjerë) të artit bashkëkohor në Kosovë dhe ka rezultuar në lidhje të ngushta në mes të artistëve kosovarë dhe botës. Për më tepër, duhet theksuar poashtu se përpjekja e Kosovës për pavarësi është temë që është trajtuar nga artistë prominent botëror (p.sh. Wolfgang Tillmans, Phill Collins). Tash që Kosova është në proces të konsolidimit me historinë e saj, është kruciale që të përfshihen vepra të krijuara jashtë Kosovës, duke trajtuar kështu se si shteti është perfaqësuar dhe përshkruar në kohëra dhe hapësira të ndryshme.

Çka është bashkëkohorja? Çka do të thotë termi 'bashkëkohor' ashtu siç do të kuptohet ai në raport me koleksionin e MABK? Termi 'bashkëkohor' nënkutpon artistët te cilët punojnë/veprojnë sot. Por, ajo njekohësisht i preferohet një periudheje kohore në artin vizuel e cila periudhë fillon në hoving e dytë të shekullit XX. Kjo periudhë kohore quhet poashtu 'pasmoderna.' Tutje, termi përfshinë praktika artistike të cilat prekin trendet dhe sensibilitetet e kohës së tashme, duke shfrytëzuar kështu një gjuhë vizuele e cila e tregon një artist të informuar.

Në terma praktik, cili duhet të jetë raporti në mes të koleksionit të MABK-së dhe koleksioneve të tjera ekzistuese në vend? Galeria Kombëtare e Kosovës do të jetë e përkushtuar që ta pasurojë koleksionin me vepra të artistëve të shekullit XX. Ndërsa, MABK do të përkushtohët që të koleksionojë vepra të artit bashkëkohor, duke filluar nga mesi i viteve 1990 deri më sot.

10.2. Politikat e koleksionimit

10.2.1. Kriteret dhe rregullat e zhvillimit të koleksionit – Përvetësimi (Blerja)

Muzeu i artit është një institucion kulturor jo-profitabil, edukativ, i cili është i dedikuar që të koleksionojë, ruaj, konservojë, dokumentojë, studiojë dhe ekspozojë vepra arti. Si i tillë, muzeu duhet ti adaptojë principet e përgjithshme nga Principet e Muzeve te Artit (PMA). Kësisoj, ai duhet ti adaptojë specifikisht politikat e përvetësimit të dhe tërheqjes zyrtare të veprave të artit dhe t'i ndjek procedurat siç udhëzohën nga PMA.

Për sa i përket përvetësimit, duhet të adaptohet kriteri i pajtueshmërisë me profilin e koleksionit dhe kjo procedurë të referohet te Regullat e Procedurave të Përvetësimit. Më poshtë janë kriteret të cilat duhet të kihen parasysh kur vendoset që të përvetësohet një vepër:

a. *Rëndësia:* Objekti/vepra duhet ti shërbejë misionit të MABK;
b. *Përdorimi*: Objekti/vepra duhet ta ketë potencialin që të mund të shfrytëzohet për ekspozita dhe/ose hulumtime dhe për arsye shkencore;
c. *Vendi*: MABK duhet ta ketë mundësinë që të ofrojë hapësirë adekuate për veprat të cilat përvetësohen;

Kriteret e njejta aplikohën për donacione. Për më tepër, pranimi i dhuratës/donacionit duhet të vendoset në saje të nevojës për mbrojtje në rastin e veprave me vlerë të etabluar artistike dhe historike, dhe në rast se ato dëmtohen apo humben, nëse nuk merren nga muzeu.

10.2.2. Komisioni për zhvillimin e koleksionit

Në bazë te statutit të MABK-së, Drejtori/ja e përgjithshëm/me së bashku me Drejtorin/en e koleksionit dhe konservimit do t'i sygjerojnë vepra për përvetësim Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Drejtori/ja dhe Ministri mund të kërkojnë ekspertizë shtesë, të palës së tretë, ose mund të emërojë Komisionin për zhvillim të koleksionit, i cili do të ketë një mandat më të gjatë.

Çdo përvetësim/blerje e sygjeruar duhet të shoqërohet me një arsyetim e cila do ta shpjegojë rëndësinë e përvetësimit të veprës në fjalë, si dhe të listojë kriteret për mirëmbajtje dhe konservim. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nuk mund ta mënjanoj përvetësimin e veprës, përveç nëse ajo ka implikime serioze ekonomike dhe buxhetore, të cilat do ta rrezikonin të stabilitetin financiar të MABK-së, ose të pervetësimeve të tjera në të ardhmen; poashtu edhe nëse ekzistojnë arsye ligjore të cilat do ta bënin përvetësimin joligjor dhe që do ta shkelnin ligjin e Republikës së Kosovës.

10.2.3. Rregullat e zhvillimit të koleksioneve – Asgjësimi

Asgjësimi është procesi i largimit të një vepre nga regjistrat e koleksionit me anë të dhurimit, shkëmbimit, shitjes, apo edhe shkatërrimit. Një gjë e tillë arsyetohet vetëm nëse ky proces avancon cilësinë dhe përmbajtjen e koleksionit. Arsyet kuratoriale për largim nga koleksioni duhet të etablohen para se të kihet në konsideratë që një vepër të hiqet nga koleksioni i muzeut. Çdo largim duhet të bëhet në përputhje me qëllimet e koleksionimit, të cilat janë të detajuara në politikat menaxhuese të koleksionit të muzeut. Ky veprim mund te mirret vetëm për arsye të avancimit të misionit të muzeut, që ta përmirësojë dhe ta ngritë kualitetin dhe fushveprimin e koleksionit. Në rast se gjenerohen të ardhura nga procesi i asgjësimit, ato nuk duhet të shfrytëzohen për asgjë tjetër, përveç për blerje ose investim në ruajtje të koleksionit.

10.3. Kujdesi për koleksionet dhe vazhdimësia e saj

Mirëmbajtja e koleksioneve të artit është praktikë e kushtueshme. Kjo praktike kërkon një përkushtim afatgjatë të ofrimit të kapitalit njerëzor dhe financiar.

Kosova nuk ka përvojë të mirë kur vie puna te menaxhimi i koleksioneve, siç është shembulli me koleksionin e Hotel Grand Prishtina. Një numër i veprave aty janë zhdukur krejtësisht, pjesërisht për shkak të çështjes së taksave, e disa të tjera për shkak të kushteve të dobëta klimatike në hotel. Tutje, dy koleksionet e krijuara rishtazi nga MKRS, ajo e Manifesta 14 dhe ajo e krijuar gjatë pandemisë COVID-19, nuk kanë ende hapësira adekuate dhe të sigurta për tu vendosur. Departamenti për Konservim dhe Menaxhim të Koleksioneve në MABK duhet që të mësojë nga këto përvoja dhe t'u shmanget praktikave të ngjashme.

Duhet të theksohet se veprat e artistëve kosovarë, veprat e të cilëve padyshim se do të konsiderohen për kolektim nga MABK, në masë të madhe mbahen në kushte jo ideale nga familjet e tyre. MABK duhet të kujdeset për gjendjen materiale të veprave të cilat do t'i përvetësojë, që kësisoj t'i shmanget harxhimit të resurseve për vepra të cilat janë të dëmtuara deri në një pikë e cila paumundëson shpëtimin e tyre.

10.4. Kthimi i trurit

Duke pasur parasysh kontekstin historik të Kosovës, dhe kësisoj rëndësinë e diasporës së saj në zhvillimin e Kosovës, është kruciale që kjo kategori - profesionistët e ri, dhe kontribuesit e tjerë nga diaspora- të përfshihen në MABK, qoftë duke përmbushur pozita profesionale, duke u bërë anëtar të saj apo edhe duke kontribuar financiarisht dhe në këtë mënyrë duke u bërë miq të institucionit.

10.5. Restaurimi

Restaurimi është një aspekt i rëndësishëm i koleksionimit dhe njëkohësisht një komponentë e rëndësishme e mbrojtjës së kujtesës kolektive. Kosova ka mungesë të hapësirave të cilat

mundësojnë restaurimin e veprave të artit dhe asteve të tjera të trashëgimisë kulturore. Kështu, ajo ka nevoj të menjëhershme për një hapësirë që do të mbikqyrte prezervimin dhe restaruimin e trashëgimisë së saj. Kësisoj, krijimi i MABK është një mundësi që të krijohet një qendër, e para e llojit të vet, e cila do të restauronte edhe objekte të cilat i takojnë muzeve dhe institucioneve të tjera të Kosovës.

Roli i restauruesit është i specializuar. Ky rol kërkon arsim të avancuar, dije që nuk ofrohet nga asnjë institucion të arsimit të lartë në Kosovë. Restauruesi duhet të dij se si ti mbaj veprat e artit në gjendje të mirë, kjo nënkupton veprime të ndryshme varësisht nga materiali nga i cili objekti është i krijuar. Duke marrë parasysh se artistët bashkëkohor veprojnë në një sërë mediumesh të ndryshme, nevoja për restaurues që ka shkollim në hap me kohën, është kruciale.

10.6. Buxheti vjetor për përvetësime/blerje

Marrë parasysh gjendjen ekonomike të Kosovës, është vështirë që të propozohet një shumë për përvetësimin/ blerjen vjetore të veprave për koleksionin e MABK-së. Në vend të kësaj, kemi vendosur qe të marrim shembuj nga ca institucione të shteteve fqinje. Si për shembull, shtetet si Greqia, Kroacia, Sllovenia, Polonia, të cilët shembuj mund të jenë një referencë e mirë për MABK. Në bazë të të dhënave të marra, suma e pergjithshme e pervetësimeve/ blerjeve bashkarisht në mes të sektorit privat dhe atij publik është në mes të € 400,000.00 – 200,000.00.

10.6.1. Fonde të tjera

1. Taksat;
2. Kompani private;
3. Diaspora;
4. Rrethi i donatorëve (Miqtë e muzeut/ anëtarët);
5. Fondacionet;

11.
FAZAT E IMPLEMENTIMIT

11. Fazat e implementimit

Punimet drejt dy caqeve paralele

— **Caku i parë** synon përvojë, vizibilitet, mbarëvajtje, rezultate konkrete. Ky cak synon që para vitit 2024 të ngriten kontura të forta e të qëndrueshme të MABK Rilindja.

— **Caku i dytë** synon zgjidhje afatgjatë, institucion shembullor, reputacion ndërkombëtar. Ky cak synon një vizion afatgjatë duke ndjekur procedurat dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për ngritjen e një institucioni muzeal, që nënkupton përveç tjerash proces më të ngadaltë dhe të kujdesshëm. Sipas këtij caku para vitit 2027–2030 muzeu do të jetë i hapur për publikun.

Veprimet e parapara për vitit 2022:

Aktiviteti	Data
Simpoziumi (Konceptimi programor e artistik i MABK)	28 tetor 2022
Aktet e përmbledhura e redaktuara të simpoziumit (Konceptimi programor e artistik i MABK)	15 nëntor 2022
Themelimi ligjor i institucionit (akti i themelimit, statuti, rregulloret e brendshme dhe vendimet tjera)	1 nëntor 2022
Struktura organizative e institucionit (organogram, trupat drejtuese dhe menaxhuese, përcaktimin e funksioneve dhe përgjegjësive)	1 nëntor 2022
Grupi punues për çështjet e arkitekturës (koncepti ndërtimor, arkitektonik dhe hapësinor)	1 dhjetor 2022

Plani sipas cakut të parë

Themelimi ligjor i MABK RILINDJA	korrik/ gusht 2023
Emërimi i drejtorit dhe drejtorit artistik/kuratorit	shtator 2023
Vendimi për ndërtesën MABK RILINDJA	shtator 2023
Aprovimi i statutit të MABK RILINDJA	shtator/ tetor 2023
Faza e parë e funksionalizimit të ndërtesës	tetor 2023/ prill 2024
Ekspozita e parë provizore e muzeut (Caku i parë)	2025
Faza e dytë e implementimit/raporti i fizibilitetit	2025/2026

Plani sipas cakut të parë

Konkursi ndërkombëtar për arkitekturën e muzeut/përzgjedhja	2025
Përgatitja e projektit kryesor për implementim	2026
Tenderi për ndërtim të MABK RILINDJA	2026
Nisja e punimeve në ndërtesën e re	dhjetor 2026
Institucioni i ri me koleksion, bord dhe drejtor (Caku i dytë)	2027—2030

Ekipi punues dhe bashkëpunëtorët
Këshilli Inicues për Muzeun e Artit Bashkëkohor është themeluar me vendim të ministrit Hajrulla Çeku nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë më 31 maj, 2022 (Nr. 75/2022). Është i përbërë nga: Yll Rugova (kryesues), Petrit Halilaj, Flaka Haliti, Sislej Xhafa, Erëmirë Krasniqi, Zake Prelvukaj, Nita Salihu Hoxha, Valdete Pacolli, Fisnik Abazi, përfaqësues i MKRS-së. Anëtar pa të drejtë vote është: Rozafa Imami (MKRS), dhe sekretare: Arbenita Nuza (MKRS). Anëtarët e Këshillit bashkërisht kanë punuar në përpilimin e dokumentit sipas temave të ndara. Punët janë koordinuar përmes takimeve javore që janë mbajtur në vazhdimësi.

Megjithëse të gjithë anëtarët kanë qenë të përfshirë në të gjitha pjesët e këtij dokumenti, puna në përpilimin e konceptit themelues është realizuar fillimisht nga nëngrupet punuese sipas temave.

Kontekstet e arkitekturës
Valdete Pacolli, Sislej Xhafa;
Këshillim i jashtëm: Yehuda Safran, Alenka Gregorič, Jernej Šipoš, Boris Matić.

Koleksioni
Flaka Haliti;
Këshillim i jashtëm: Vesa Sahatçiu, Alex Fisher.

Draft statuti dhe aspekti ligjor
Yll Rugova, Zake Prelvukaj, Fisnik Abazi, Petrit Halilaj;
Këshillim i jashtëm: Martin Heller.

Programi dhe funksionet
Sislej Xhafa, Valdete Pacolli.

Departamentet dhe organogrami
Erëmirë Krasniqi, Nita Salihu Hoxha;
Këshillim i jashtëm: Christina Werner.

Redaktimi i përgjithshëm i teksteve
Erëmirë Krasniqi, Yll Rugova;

Dizajni grafik
Nita Salihu Hoxha

Simpoziumi i përgjithshëm
Materialet bazë për konceptin e themelimit derivojnë nga simpoziumi i mbajtur më 28 tetor, 2022 në Hotel Grand me titull *Me çka të të peshoj, me sy apo me zemër?*. Ligjerues dhe kontribues të simpoziumit, të cilët i falënderojmë kanë qenë: **Komuniteti** – Övül Ö. Durmuşoğlu, Joanna Warsza, Cristiana Colli, Nita Zeqiri, Vullnet Sanaja (moderator); **Koleksioni** – Arta Agani, Ana Janevski, Catherine Nichols, Vesa Sahatçiu, Ajola Xoxa (moderatore); **Arkitektura** – Përparim Rama, Vala Osmani, Benjamin Foerster-Baldenius, Jon Maass, Bekim Ramku (moderator); **Politikat kulturore** – Hedwig Fijen, Klodeta Krasniqi, Nicolas Bourriaud, Leutrim Fishekqiu, Arif Muharremi (moderator).

Vizita studimore
Materialet të tjera për konceptin e themelimit derivojnë edhe nga vizita studimore e mbajtur më 6–9 nëntor 2022 në Amsterdam, Roterdam, Tillburg të Holandës. Institucionet kulturore që janë vizituar, e që i falënderojmë kanë qenë: Berber Meindersma, Het Hem, Amstedam; Arthur van Beek, Sexyland, Amsterdam; Rein Wolfs dhe Vincent Van Velsen, Stedelijk museum, Amsterdam; Emily Pethick, De Rijksacademie, Amsterdam; Barbara Bos, Voorlinden në Wassenaar; Yoeri Meessen dhe Fokke Moerel, Depot Boijmans Van Beuningen, Roterdam; Sofia Hernandez Chong Cuy, Kunstinstituut Melly, Roterdam; Winy Maas, MVRDV, Roterdam; Muzeu De Pont, Tilburg. Gjatë vizitës delegacioni i KIMAB ka qenë i shoqëruar në vazhdimësi nga drejtoresha e përgjithshme e Manifestës, z. Hedwig Fijen, bashkë me zyrtarët e këtij fondacioni Emilia van Lynden, Marieke van Hal, dhe Nita Deda. Vizita është organizuar nga Manifesta në Amsterdam.

Punëtoria e arkitekturës
Materialet bazë për konceptin arkitekturës janë plotësuar nga punëtpria e mbajtur më 14 shkurt, 2023 në Qendrën për Praktikë Narrative me titull *Muzeu në Rilindje, ruajtja e së ardhmës, frymëzimi i së kaluarës*. Ligjerues dhe kontribues të punëtorisë të cilët i falënderojmë kanë qenë: Arbër Sadiku, Gëzim Paçarizi, Bujar Demjaha, Ardita Byci Jakupi, Bekim Ramku, Sali Shoshi.

Tools for De-modernising
Me referim nga KIMAB, anëtarët Yll Rugova dhe Erëmirë Krasniqi kanë përfaqësuar Këshillin dhe muzeun e ardhshëm në një seri takimesh të mbajtura online dhe në punëtorinë tre-ditore të organizuar nga 20-24 qershor, 2023 në Roterdam, me titull Tools for De-modernising, me ftesë nga drejtoresha e këtij institucioni Sofia Hernandez Chong Cuy.

Punëtoria përmbyllëse në Prishtinë
Me qëllim të kompletimit të të gjitha materialeve të parapara për themelimin e Muzeut të Artit Bashkëkohor është organizuar një punëtori përmbyllëse dy-ditore në Prishtinë më 7 dhe 8 qershor, 2023. Përveç anëtarëve të këshillit, kontribut në përpilimin e dokumenteve kanë dhënë edhe zyrtarët nga MKRS: Drejtorsha e departamentit e kulturës Jehona Shyti, zyrar ligjor Mehdi Uka, udhëheqës i divizionit për burime njerëzore, Taulant Balaj, kuratore e Galerisë Kombëtare të Kosovës, Hana Halilaj. Falënderim i veçantë për sekretarët në detyrë, Besim Bislimi dhe Feim Hoxha.

Për më tepër, falënderojmë institucionet që në mënyrë të vazhdueshme kanë mbështetur nismën përmes diskutimeve dhe konsultimeve, duke përmendur *Museum of Modern Art në Varshavë – MSN* me Joanna Mytkowska dhe Jagna Lewandowska, *National Museum of Contemporary Art – ΕΜΣΤ* me Katerina Gregos, Museum of Contemporary *Art në Zagreb – MSU* me Zdenka Badovinac dhe Nataša Ivančević, si dhe *Cukrarna* në Lubjanë, me Alenka Gregorič.